



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/19
Datë: 15.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncepti Dokumenti për Kontestet Administrative.
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administratës Publike
Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

KONCEPT DOKUMENTI
PËR KONTESTET ADMINISTRATIVE

Prishtinë, prill 2017

Kapitulli 1: Hyrje

Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Drejtësisë¹ vend të veçantë dhe shumë të rëndësishëm i kanë dhënë reformimit të drejtësisë administrative duke e konsideruar si prioritare rregullimin e kësaj fushe, duke marrë parasysh faktin se në fushën e gjyqësisë administrative aktualisht është duke u aplikuar ligji për konfliktet administrative, i cili rezultoi të ketë një numër të konsiderueshëm të zbrazësive dhe paqartësive ligjore, e që për pasojë ka mosefikasitetin dhe vonesat e shumta në procedurë gjyqësore administrative dhe në shkëlqen e të drejtës së qytetarit për gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor siç parashihet me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Si rezultat i kësaj Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Drejtësisë kanë inicuar rishikimin e legjislacionit nga fusha e drejtësisë administrative që mundëson rregullimin e fushës dhe realizimin e të drejtave të palëve të përfshira në proces.

Një sistem i drejtësisë administrative që funksionon mirë është parakusht kyç për të siguruar ekzistimin e një administrate publike llogaridhënëse dhe efikase. Fatkeqësisht, në Kosovë ka mangësi në këtë aspekt. Raporti i Progresit i KE-së 2016² i është referuar rritjes së numrit të lëndëve të vjetra të pazgjidhura të kontesteve administrative si arsye kryesore për besimin e ulët të publikut në sistemin gjyqësor. Sipas anketës Barometri i Ballkanit, vetëm 31% e popullsisë së Kosovës ka besim në gjykata dhe në gjyqësor³. Numri i lëndëve të vjetra administrative në fund të vitit 2015 ishte 5380, që paraqet një rritje prej 1341 nga viti 2014. Raporti i Progresit i KE-së e ka inkurajuar shtetin që të adresojë çështjen e rritjes së numrit të lëndëve të vjetra administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Po ashtu, Raporti i Matjes Standarde i SIGMA-s për Kosovën i vitit 2015⁴ tërheq vëmendjen në faktin se qasja në drejtësinë administrative minohet nga mosefikasiteti i sistemit të gjykatave i cili është në gjendje të përballet vetëm me një pakicë të lëndëve që pranohen në gjykata.

Në mënyrë që të përmirësohet kjo gjendje Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Drejtësisë bashkë me mbështetjen e OECD/SIGMA-s, kanë vendosur të vënë një theks të veçantë në reformimin e sistemit të drejtësisë administrative së pari duke analizuar arsyet e problemeve ekzistuese e pastaj duke i adresuar ato me masa relevante të politikave, përfshirë intervenimin rregullativ, nëse është e nevojshme. Ky aktivitet është në përputhje me Planin Strategjik të Gjyqësorit të Kosovës 2014-2019⁵, i cili po ashtu thekson nevojën për përmirësimin e administrimit të drejtësisë (shtylla II) dhe për ndërtimin e besimit dhe mbështetjes në gjyqësor (shtylla I).

Në bazë të Vendimit Nr. 106/2016 të datës 09.02.2016 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administratës Publike është themeluar Grupi Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për

¹ Rregullore Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Shtojca 1

² https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf

³ http://www.rcc.int/seeds/files/RCC_BalkanBarometer_PublicOpinion_2016.pdf

⁴ http://www.sigmaweb.org/publications/Baseline_Measurement_2015_Kosovo.pdf

⁵ www.gjyqesori-rks.org/GetDocument/167

Ligjin për Kontestet Administrative. Grupi Punues përbëhet nga dymbëdhjetë anëtarë, duke përfshirë përfaqësuesit nga departamentet ligjore të Ministrisë së Administratës Publike, Ministrisë së Drejtësisë, Zyrës së Kryeministrit, Këshillit Gjyqësor të Kosovës si dhe gjyqtarët e Departamenteve për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit.

Koncepti dokumenti është përgatitur duke u bazuar në diskutimet e mbajtura në disa takime të grupit punues gjatë pranverës, verës dhe vjeshtës së vitit 2016, si dhe në intervistat individuale të zhvilluara me përfaqësuesit e gjyqësorit, ministrive, përfaqësuesit e organizatave donatore që veprojnë në Kosovë dhe palët e tjera kyçe të interesuara. Qëllimi i konceptit dokumentit është që të përshkruajë problemet ekzistuese, të analizojë shkaqet dhe opsionet alternative për adresimin e tyre dhe në fund të sugjerojë opsionin e rekomanduar.

Rregullimi i kornizës ligjore ku do të mundësohej realizimi i çështjeve të mësipërme, ndërlidhet me objektivin e Qeverisë Nr. 2.5, zbatimi i reformave në administratën publike përmes rishikimit cilësor dhe sasior të agjencive shtetërore duke përfshirë kornizën e nevojshme ligjore dhe aktivitetin 2.5.2 rregullimi i legjislacionit në fushën e organizimit të Administratës Publike, në Sherbimin Civil, për Paga, për Konfliktet Administrative, dhe për lirin e asociimit të OJQ-ve.

Kapitulli 2: Përshkrimi i gjendjes aktuale dhe përkufizimi i çështjes/ problemit kryesor

2.1. Informata dhe shpjegime

Hyrje

Organizimi i sistemit gjyqësor në Kosovë rregullohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për Gjykatat dhe me Ligjin për Këshillin Gjyqësor. Sipas Ligjit për Gjykatat, në territorin e Republikës së Kosovës janë shtatë (7) Gjykata Themelore të shkallës së parë. Ligji përcakton organizimin e brendshëm të Gjykatave Themelore, si vijon:

- 1) Departamenti për Çështjet Ekonomike që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- 2) Departamenti për Çështjet Administrative që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- 3) Departamentet për Krimet e Rënda që veprojnë në selinë e secilës Gjykatë Themelore;
- 4) Departamentet e Përgjithshme që veprojnë në secilën Gjykatë Themelore, si dhe në secilën degë të Gjykatës Themelore;
- 5) Departamentet për të Mitur, që veprojnë në kuadër të Gjykatave Themelore.

Me Ligjin për Gjykatat është krijuar edhe Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë me juridiksion territorial për tërë Republikën e Kosovës, e cila ka të njëjtën strukturë organizative si Gjykata Themelore e Prishtinës. Gjykata Supreme është shkalla me e lartë gjyqësore në Kosovë. Gjykata Supreme përfshinë një Panel të Ankesave për Agjencinë Kosovare të Pronës dhe Dhomën Speciale të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e të cilës janë pjesë e Gjykatës Supreme. Bazuar në ligj, organizimi, mbikëqyrja dhe funksionimi i duhur i gjykatave është përgjegjësi e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sistemi gjyqësor i Kosovës aktualisht përbëhet nga 350 gjyqtarë.

Sipas Ligjit për Gjykatat, Gjykata Themelore e Prishtinës – Departamenti për Çështje Administrative është kompetent që të gjykojë dhe vendos për çështjet administrative për tërë territorin e Kosovës. Departamenti ka gjithsej 7 gjyqtarë, dy prej të cilëve merren me lëndët e Divizionit Fiskal si dhe 8 anëtarë të stafit mbështetës. Në Gjykatën e Apelit është themeluar Departamenti për Çështje Administrative si gjykatë e shkallës së dytë dhe Gjykata Supreme është kompetente për të vendosur për mjetet e jashtëzakonshme juridike. Bazuar në statistikën e gjysmës së parë të vitit 2016, Gjykata e Apelit e ka mbështetur aktgjykimin/vendimin e shkallës së parë në 85% të lëndëve administrative. Kjo tregon se sipas Gjykatës së Apelit, cilësia e aktgjyqimeve/vendimeve të shkallës së parë është e mirë.

Procedura gjyqësore administrative rregullohet me Ligjin për Konfliktet Administrative (LKA) i cili ka hyrë në fuqi me datën nëntor 2010, në pajtim me nenin 80.5 të Kushtetutës së Kosovës – pasi që nuk ishte nënshkruar nga Presidenti në përputhje me afatin e paraparë kushtetues.⁶

Problemet kryesore të cilat kanë dalë në sipërfaqe në fushën e drejtësisë administrative janë:

1) Numri shumë i madh i lëndëve të vjetra administrative (backlog) dhe koha tepër e gjatë e veprimtimit për tu marrë me ankesa të individëve kundër akteve të organeve administrative;

2) Problemet me kornizën ligjore në fushën e procedurës së gjyqësisë administrative, të cilat mund të grupohen në tri nën-kategori:

a) LKA nuk siguron mbrojtje efektive të të drejtave të individëve kundër akteve dhe veprimeve të paligjshme të autoriteteve administrative;

b) disa hapa procedural nuk rregullohen në LKA prandaj gjyqtarëve administrativë u duhet të punojnë paralelisht me dy kode të procedurës (me LKA dhe me Ligjin e Procedurës Kontestimore, LPK), të cilat përveç komplikimit të punës së tyre ditore po ashtu krijojnë edhe mundësi për mos-zbatim të njëtrajtshëm të rregullave të procedurës nga gjyqtarët e ndryshëm;

c) korniza ligjore përmban disa mospërputhje të brendshme (në mes të LKA-së dhe LPK-së si dhe në mes të LKA-së dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, LPPA) dhe dykuptimësi (paqartësi) që po ashtu nuk sigurojnë zbatim të njëtrajtshëm dhe efikas të procedurës së gjykatës administrative ose të mbrojtjes së të drejtave të individëve.

⁶ Sipas nenit 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Kosovës përcaktohet se "Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare".

2.2. Lëndët e vjetra administrative dhe koha mesatare e gjatë e procedimit të lëndëve administrative

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatat, të gjitha lëndët administrative që nuk ishin përfunduar deri me 31.12.2012 janë bartur nga Gjykata Supreme në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës (DÇA). DÇA u bë gjykata kompetente për tu marrë me lëndët administrative në tërë territorin e Kosovës. DÇA-së i janë bartur gjithsejtë 1947 lëndë të pazgjidhura me 1 janar 2013. Si rrjedhojë, DÇA është detyruar të merret me zgjidhjen e problemit të lëndëve të vjetra (të prapambetura) nga momenti i themelimit të saj.

Me 1 janar 2016 numri i përgjithshëm i lëndëve të pazgjidhura në DÇA kishte arritur në 5380, kështu që numri i tyre ka kaluar dyfishin brenda 3 vitesh. Kjo tregon se ka probleme serioze me efikasitetin e gjykatave. Koha⁷ e llogaritur e zgjidhjes [së lëndëve] administrative bazuar në të dhënat për periudhën 2015-2016 është përafërsisht 818 ditë. Në shumicën e vendeve të BE-së koha e llogaritur për zgjidhjen e lëndëve është së paku dy herë më e shkurtër, për shembull në Slloveni ajo është 112 ditë, në Suedi 114 ditë⁸.

Sipas Raportit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për vitin 2016, DÇA ka pranuar 2216 lëndë të reja dhe janë zgjidhur 2404 lëndë⁹, që nënkupton se mesatarisht janë zgjidhur 343.4 lëndë nga një gjyqtar gjatë periudhës raportuese. Edhe pse gjatë vitit 2016, gjyqtarët administrativë të shkallës së parë ishin në gjendje të zgjidhnin më shumë lëndë se sa që ishin parashtruar në gjykatë, me këtë ritëm të zvogëlimit të numrit të lëndëve të vjetra (prapambetura) do të duhen 14.8 vjet për të arritur në situatën ku kontestet administrative do të zgjidhen brenda një viti (365 ditësh) mesatarisht (me kush që numri i lëndëve të reja që vijnë në gjykatë të mbetet i njëjtë). Prapëseprapë do të jetë kohë më e gjatë se në disa vende anëtare të BE-së, por mund të konsiderohet se është në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Sipas një analize të bërë nga KGJK, kohëzgjatja mesatare për zgjidhjen e një lënde të Divizionit Fiskal, i cili është pjesë e DÇA-së, është 639 ditë. Në vitin 2015, Divizioni Fiskal ka zgjidhur 341 lëndë.¹⁰ Tabela më poshtë paraqet një pasqyrë të statistikave kryesore lidhur me punën e DÇA-së ndërmjet vitit 2013 dhe vitit 2016.

Statistikat mbi punën e DÇA-së	Viti	Viti	Viti	Viti
	2013	2014	2015	2016 ¹¹
Numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese	1947	2560	4039	5380

⁷Koha e llogaritur e zgjidhjes [së lëndëve] është një prej indikatorëve kyç që përdoret nga Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian për matjen e efikasitetit të gjykatave. Ajo paraqet një vlerësim të numrit të ditëve që nevojiten mesatarisht për të zgjidhur një lëndë në gjykatë. Ajo llogaritet duke e pjesëtuar numrin e lëndëve të pazgjidhura me numrin e lëndëve të zgjidhura në fund të vitit, e duke e shumëzuar me 365 (ditë). Në Kosovë numri i lëndëve të pazgjidhura me 1 janar 2016 ishte 5380 dhe gjykata administrative është në gjendje të zgjidh rreth 2400 lëndë në vit (bazuar në të dhënat nga gjysma e parë e vitit 2016).

⁸Bazuar në Tabelën e BE-së për Rezultatet në Drejtësi 2016: http://ec.europa.eu/justice/effective-justice/files/justice_scoreboard_2016_en.pdf

⁹Raporti i KGJK-së për Gjykatat, për Vitin 2016

¹⁰<http://www.gjyqesori-rks.org/en/kjc/report/list/1> Raporti i KGJK-së mbi Kohëzgjatjen e procedurave të hipotekare, të falimentimit dhe tatimore, 2015

¹¹Raporti i KGJK-së për Gjykatat, janar-shtator 2016

Numri i lëndëve të pranuara	1720	2568	2300	2216
Numri i lëndëve në procedurë e sipër	3667	5169	6339	7596
Numri i lëndëve të zgjidhura	1107	1130	959	2404
Numri i lëndëve të pazgjidhura	2560	4039	5380	5192

Bazuar në statistikat lidhur me lëndët e reja që kanë ardhur në gjykatë gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2016, numri më i madh i ankesave është parashtruar kundër vendimeve për personat me nevoja të vecanta (aftësinë e kufizuar) (23%), për çështje doganore (15%), tatime (12.5%) dhe konteste në shërbimin civil (12.5%). Këto po ashtu janë kategoritë në të cilat bëjnë pjesë numri më i madh i lëndëve të vjetra.

DÇA nuk mban kurrfarë statistikash lidhur me kohëzgjatjen e procedurave individuale, numrin e seancave dhe kohën ndërmjet seancave në një lëndë administrative, numrin e seancave të shtyra dhe arsyet e shtyrjes së seancave, etj. Për shkak të kësaj, aktualisht nuk është e mundur të bëhet një analizë më e detajuar lidhur me menaxhimin e lëndëve administrative bazuar në statistika në mënyrë që të identifikohen shkaqet e mundshme të shtimit të lëndëve të vjetra. Megjithatë, në bazë të informacioneve të marra përmes intervistave një prej çështjeve që ndikon negativisht në efikasitetin e menaxhimit të kontesteve administrative ka qenë përfaqësimi jo i rregullt i organeve publike në procedurat gjyqësore.

Avokatura Shtetërore (ASH) e Republikës së Kosovës vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe ka obligim që të përfaqësojë autoritetet publike të Republikës së Kosovës në procedura gjyqësore, të arbitrazhit dhe në ato administrative. Bazuar në informacionet e dhëna gjatë intervistave, ASH nuk është në gjendje që në mënyrë të vazhdueshme të sigurojë bashkëpunimin dhe komunikimin efektiv me organet administrative kundër të cilave është parashtruar ankesë në gjykatë. Si rrjedhojë, ASH nuk mund t'i ofrojë gjykatës dokumentet dhe informacionet e nevojshme për konstatimin/konfirmimin e fakteve të lëndës. Në mungesë të informacioneve relevante nga organet publike dhe/ose në mungesë të përfaqësimit adekuat të organeve publike, shtyhen seancat dhe merren vendime në mungesë në favor të parashtruesit të ankesës, pa hyrë në lëndën e kontestit.

Sipas nenit 37 (3) të LKA-së, pala është e obliguar që në afatin e caktuar t'i dërgojë gjykatës të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me lëndën. Nëse pala e paditur edhe pas kërkesës së dytë nuk i paraqet shkresat e lëndës, apo nëse deklaron se nuk mund t'i dërgojë, gjykata mund të vendosë për çështjen edhe pa shkresat e lëndës. Pasi që dispozitat e ligjit nuk përcaktojnë ndonjë pasojë për mosrespektim të urdhrave të gjykatës (përveç ndoshta se në mungesë të palës vendimi merret në favor të parashtruesit, që nuk kufizon veprimet e ardhshme të organit publik), disa organe publike kanë vendosur të mos marrin pjesë në procedura, të cilat mund t'i humbin.

Dy çështjet e tjera të cilat bazuar në informacionet e siguruar përmes intervistave – ndikojnë negativisht në kohëzgjatjen e procedurave përfshijnë problemet me dorëzimin e dokumenteve organeve publike dhe shtyrjen e seancave për shkak se nuk është në dispozicion përkthyesi i gjykatës ose referenti përgjegjës për të mbajtur procesverbalin e seancës. Dorëzimi i dokumenteve ka qenë problematik si duket për shkak të sistemit emrave të ri të rrugëve të aplikuar kohëve të fundit, me të cilin akoma nuk janë familjarizuar postierët. Seancat janë shtyrë për shkak se përkthyesi i vetëm në DÇA ka qenë i zënë në ndonjë seancë tjetër që zhvillohej në

të njëjtën kohë ose referenti i gjykatës që e mbështet një gjyqtar të caktuar të DÇA-së ka qenë i sëmurë ose në pushim. Edhe pse mund të ketë edhe përkthyes ose referentë të tjerë në dispozicion në departamentet e tjera të Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë seancës, ajo prapë do të shtyhet pasi që referentët duket se nuk kanë mundësi të lëvizin në kuadër të organizimit të së njëjtës gjykatë.

Në fund, numri i mundësive të ankimit (në gjyqësor e po ashtu edhe në organet administrative) po ashtu ndikon negativisht në kohëzgjatjen e tërësishme të procedurave në kontestet administrative. Për shembull, sipas Ligjit ekzistues për Nëpunësit Civilë tashmë ekzistojnë dy mundësi të ankimit brenda administratës në rastet e rekrutimit, masave disiplinore dhe largimeve nga puna. Shkalla e fundit në kuadër të administratës është Bordi i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, kundër vendimeve të të cilit mund të bëhet ankesë në gjykatë (e cila përbëhet nga tri shkallë). Kjo nënkupton se bashkë me organin i cili e ka marrë vendimin fillestar, janë gjithsejtë gjashtë shkallë që mund të trajtojnë një kontest administrativ para se ta arrihet vendimi përfundimtar.

Gjatë përgatitjes së këtij koncept dokumenti nuk ka pasur në dispozicion statistika specifike lidhur me numrin e kontesteve në shërbimin civil në secilën shkallë administrative prandaj nuk ka qenë e mundur të vlerësohej efikasiteti i secilës shkallë. Megjithatë, meqë kontestet që kanë të bëjnë me shërbimin civil janë ndër më të zakonshmet në gjykatën e shkallës së parë, efektiviteti i shkallëve para-gjyqësore mund të mos jetë adekuat dhe në vend se të ofrojnë zgjidhje përfundimtare për një numër të konsiderueshëm kontestesh para ndërmarrjes së procedurës gjyqësore, ato thjeshtë vetëm e rrisin numrin e hapave që duhet të ndërmerren para se të arrihet zgjidhja përfundimtare në gjykatë. Përveç kësaj, bazuar në statistikat e gjysmës së parë të vitit 2016, në 59% të vendimeve të marra në kontestet që lidhen me shërbimin civil gjykata e shkallës së parë ka vendosur në favor të parashtruesit. Kjo po ashtu tregon se cilësia e vendimeve administrative në fazat para-gjyqësore nuk është adekuate. Shkalla e përgjithshme e aprovimit të ankesave (duke përfshirë rastet që janë tërhequr, që nuk janë pranuar të shqyrtohen ose që kanë përfunduar me marrëveshje) në të gjitha kategoritë është 58%, kështu që duket se në të gjitha fushat, ekzistimi i mundësive të ankimit administrativ paragjyqësor nuk siguron që aktet administrative të cilësisë së ulët do të (shfuqizohen) anulohen para se të arrijnë në gjykatë.

2.3. Problemet me kornizën ligjore në fushën e procedurës në gjykatës administrative

2.3.1. LKA nuk e siguron mbrojtjen efektive të të drejtave të individëve

Pamundësia e gjykatës administrative të konstatojë faktet e lëndës

Sipas nenit 37 (3) të LKA-së gjykata mund të vendos për një çështje, edhe në mungesë të dokumenteve relevante që janë të nevojshme për gjykimin e një lënde. Sipas nenit 43 (3) gjykata mund por nuk është e obliguar t'i konstatojë faktet e lëndës me vetiniciativë. Kjo mund të jetë në pajtim me parimet e procedurës civile, ku përfshihen dy palë të barabarta, megjithatë në procedurën administrative mundësia për të marrë vendim në mungesë pa i konstatuar faktet e rastit nuk siguron në mënyrë efektive se janë rivendosur të drejtat e individit. Organi shtetëror i cili nuk i ka paraqitur dokumentet dhe të dhënat relevante ose i cili ndoshta nuk ka marrë pjesë në procedura fare [shih po ashtu 2.1 lidhur me efektivitetin e SAO-s (Avokatura Shtetërore)], mund të nxjerrë një akt administrativ të ngjashëm me atë që është kontestuar, sepse materia e lëndës nuk i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe gjykata nuk ka qenë në gjendje të marrë

vendim të bazuar mbi ligjshmërinë e aktit administrativ të kontestuar (i cili mund të përmbaj këshilla për organin administrativ që të sigurojë ligjshmërinë e akteve administrative të ardhshme, nëse është e nevojshme). Si rezultat, individi i prekur duhet t'i drejtohet gjykatës sërish për tu mbrojtur kundër aktit të ri të paligjshëm të administratës.

Mos-zbatimi i vendimeve të gjykatës

Neni 68 i LKA-s përshkruan mekanizmin aktual për zbatimin (përmbartimin) e vendimeve të gjykatës. Sipas këtyre dispozitave, nëse organi administrativ nuk zbaton vendimin e gjykatës brenda 30 ditësh pasi vendimi të jetë bërë i plotfuqishëm, pala ankuese mund t'i paraqes kërkesën organit që të ekzekutojë vendimin. Nëse kjo nuk bëhet brenda 7 ditësh, pala mund të kërkojë nga gjykata të nxjerr aktin e tillë në vend të organit administrativ. Ky mekanizëm i zbatimit i mjegullon vijat e përgjegjësisë në mes të administratës dhe gjyqësorit dhe si i tillë mund të mos jetë në pajtim me parimin e ndarjes së pushteteve. Përveç kësaj, ai definitivisht nuk siguron ekzekutim efikas dhe me kohë të aktgjykimeve të gjykatës. Ligji ka krijuar një alternativë ligjore për zbatimin e vendimeve të gjykatës, e cila i mundëson organit administrativ të anashkalojë obligimin për të respektuar vendimet e gjykatës.

Ky problem, bashkë me përfaqësimin jo të rregullt të organeve publike (siç është përshkruar në 2.1) dhe pamundësia e gjykatës që të konstatojë faktet e lëndës (siç është përshkruar më lartë), bën që të lind fenomen i lojës së pingpongut me lëndët administrative ndërmjet DÇA-së dhe organeve publike, aktet e të cilave janë kontestuar në gjykatë. Mes të tjerëve, edhe Avokati i Popullit ua ka tërhequr vëmendjen shtetit dhe gjykatave për ekzistimin e këtij fenomeni, për shembull në raportin e vet të muajit gusht 2016 “Lidhur me mungesën e mjeteve juridike efektive”, i cili i ishte adresuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë¹².

Mbulimi i shpenzimeve të procedurës

Sipas nenit 64 të LKA-së, secila palë në procedurë i bart shpenzimet e veta pavarësisht kush e fiton rastin. Meqë nuk mund të supozohet se individët janë gjithmonë në gjendje që të përfaqësojnë veten në procedurat gjyqësore dhe mund të kenë nevojë për ndihmë profesionale e cila kushton, një dispozitë e tillë në mënyrë efektive e kufizon qasjen në drejtësi. Në raste të caktuara dëmi i shkaktuar nga akti administrativ mund të jetë më i vogël se sa shpenzimet e gjykatës (taksa gjyqësore bashkë me shpenzimet e përfaqësimit si dhe kohën e shpenzuar) prandaj individët mund të vendosin që të mos paraqesin ankesë për aktet administrative të paligjshme, duke minuar kështu llogaridhënien dhe ligjshmërinë e administratës publike si tërësi (përveç kufizimit të qasjes në drejtësi).

2.3.2. Mangësitë në LKA

Sipas nenit 63 të LKA-së, për çështjet procedurale që nuk janë të rregulluara në LKA aplikohen dispozitat e LPK-së. Për shembull, LKA – që ka gjithsej 72 nene – nuk përmban asnjë dispozitë lidhur me procedurat e ankesës (përveç dispozitës së përgjithshme në nenin 23 (2), se ankesat

¹² [http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/\(22.8.16\)_Ex_officio_nr._425-2015_Raport_me_rekomandime-mungesa_e_mjeteve_juridike_efektive_Eng_706228.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/(22.8.16)_Ex_officio_nr._425-2015_Raport_me_rekomandime-mungesa_e_mjeteve_juridike_efektive_Eng_706228.pdf)

parashtrihen në gjykatën e apelit), baza për pezullimin e ri-hapjes së procedurave, shqiptimi i gjobave në rast se pjesëmarrësit nuk respektojnë urdhrat e gjykatës ose nuk ekzekutojnë vendimet, etj. Sipas një vlerësimi të përafërt të gjyqtarëve, në rreth 80% të çështjeve procedurale aplikohet LPK.

Një nga arsytet për mangësitë në LKA është se ai është miratuar gjatë kohës kur procedura e gjykatës administrative përbëhej vetëm nga një shkallë e gjykatës në Kosovë – Gjykatës Supreme – dhe ai nuk është ndryshuar si duhet për tu përdorur në një sistem të gjykatës me tri shkallë. Si rezultat, gjyqtarët duhet të përdorin dy kode të procedurës paralelisht në punën e tyre të përditshme në vend se të përdorin vetëm një; kjo merr më shumë kohë dhe e komplikon punën pasi që burimi i rregullave të procedurës mund të mos jetë gjithmonë i qartë. Kjo pastaj krijon mundësi për zbatim jo të njëtrajtshëm të rregullave të procedurës nga gjyqtarët e ndryshëm.

2.3.3. Mospërputhjet në kornizën ligjore

Mospërputhjet kryesore vërehen lidhur me përkufizimin e lëndës administrative, brenda dispozitave të LKA-së, ndërmjet dispozitave të LKA-së, LPK-së dhe LPPA-së dhe në strukturën e përgjithshme të LKA-së.

Përkufizimi i lëndës administrative

Gjatë analizës së bërë në përgatitjen e këtij koncept dokumenti, janë identifikuar së paku dy raste ku korniza ligjore nuk është në përputhje me përcaktimin e mandatit të DÇA-së si organ gjyqësor përgjegjës për gjykimin e lëndëve administrative.

Rasti i parë ka të bëjë me dy raste të kundërvajtjes. Sipas Ligjit për Kundërvajtjet i cili është miratuar në vitin 2016 dhe i zbatuar prej 1 janarit 2017, mund të jenë dy organe kompetente për shqiptimin e gjobave për individët dhe personat juridik në rastet e kundërvajtjes. Ndëshkimet monetare deri në 500 euro për individët dhe deri në 1000 euro për personat juridik mund të shqiptohen nga organet administrative dhe ndëshkimet jo-monetare si dhe ndëshkimet monetare mbi limitin e cekur shqiptohen nga gjyqtarët e shkallës së parë të Departamentit të Përgjithshëm në Gjykatën Themelore. Një sistem i tillë ku një pjesë e autoritetit vendimmarrës është deleguar tek organet administrative është i zakonshëm edhe në vendet e tjera me kod civil. Megjithatë, sistemi i ankesave në lëndët e kundërvajtjeve në Kosovë është i pazakonshëm për vendet e tjera dhe çka është më me rëndësi në formatin aktual ndikon negativisht në punën e gjyqtarëve administrativë në DÇA, si dhe në individët që i parashtrojnë ankesat.

Sipas nenit 64 të Ligjit për Kundërvajtje, DÇA është kompetente për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të shkallës së parë të organeve administrative për shqiptimin e gjobave si rezultat i procedurave të kundërvajtjes. Në të njëjtën kohë, nëse në një rast të kundërvajtjes është shqiptuar një ndëshkim nga gjyqtari i Departamentit të Përgjithshëm në Gjykatën Themelore, ankesa parashtrihet në Gjykatën e Apelit. Kjo nënkupton se në rastet e kundërvajtjes do ketë mënyrë tjetër të ankesës, varësisht nga shumata e dënimit financiar – të gjitha ankesat kundër gjobave deri në 500 euro (ose 1000 euro për personat juridikë) do të trajtohen nga gjyqtarët administrativë dhe të gjitha ankesat kundër gjobave më të larta do të trajtohen nga gjyqtarët e tjerë.

Arsyeja për këtë ndryshim nuk është e qartë, sepse esenca e të dy rasteve (shqiptimi i dënimit për kundërvajtje) është e njëjtë. Ka po ashtu dallime në mandatin e gjyqtarëve në departamentet e

ndryshme kur shqyrtojnë një ankesë - nëse gjyqtari në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës së Apelit që merret me një ankesë në një rast të kundërvajtjes e konsideron gjobën tepër të lartë, ai/ajo mund të ndryshojë vendimin e gjykatës më të ulët dhe të nxjerr një vendim të ri me gjobë më të ulët. Megjithatë, gjyqtari në Departamentin për Çështje Administrative gjatë shqyrtimit të ankesës kundër një gjobe të shqiptuar nga një organ administrativ vetëm mund të shfuqizojë vendimin e ankimuar dhe të kthejë lëndën prapa te organi administrativ, sepse ai/ajo nuk ka mandat që të ndryshojë vendimin fillestar ose të merr vendim në vend të organit administrativ. Kjo do të bëjë procedurën ankimore në lëndët me dënime të vogla (të cilat përbëjnë shumicën e lëndëve) më pak efikase dhe do të zgjas kohën që i duhet palës ankuese të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të tij/saj.

Përveç kësaj, bazuar në logjikën ankimore aktuale në lëndët e kundërvajtjeve, delegimi i kompetencës vendimmarrëse te organet administrative në shumicën e rasteve të kundërvajtjes do të vërshojë DÇA-në me ankesa kundër gjobave të shqiptuara nga organet administrative. Për shembull, në nëntë muajt e parë të vitit 2016, numri i lëndëve të pranuar të kundërvajtjeve në Gjykatat Themelore ishte 275,544 – shumica e këtyre lëndëve do të trajtohen nga organet administrative duke filluar nga 1 janari 2017. Është vështirë të parashikohet numri i saktë i ankesave që do të parashtrihen kundër vendimeve të organeve administrative, por sikur gjatë muajve të parë pas zbatimit të reformës, organet administrative mund të mos kenë kompetencë që të aplikojnë dispozitat e Ligjit për Kundërvajtje (LKV), numri i vendimeve me cilësi të dyshimtë mund të jetë i lartë. Si rezultat, gjyqtarët e DÇA-së të cilët duhet të jenë të specializuar në lëndët administrative, duhet të merren shumicën e kohës me lëndët e kundërvajtjes, në të cilat aplikohen parimet ligjore të procedurës penale (çështja e fajit, qëllimit, etj.). kjo do të ndikojë negativisht në kompetencën e tyre gjatë shqyrtimit të lëndëve administrative dhe mund të ndikojë në cilësinë e vendimeve të tyre.

Një shembull tjetër i përkufizimit kontradiktor të lëndës administrative sipas kornizës ligjore aktuale në Kosovë është mbrojtja gjyqësore që sigurohet në rastet e konkurrencës. Sipas nenit 13 (1) të Ligjit për Gjykatat, kontestet lidhur me cenimin e konkurrencës, keqpërdorimin e monopolit dhe pozitës dominuese në treg dhe marrëveshjet monopoliste do të gjykojnë nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Në të njëjtën kohë, këto lëndë do të bazohen në ankesën kundër vendimit administrativ të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (i cili është nxjerr si rezultat i procedurës administrative). Është vështirë të kuptohet se pse lëndët e konkurrencës janë nën kompetencën e DÇA-së ngjashëm me ankesat e tjera kundër vendimeve të marra si rezultat i procedurave administrative.

Mospërputhjet brenda LKA-së dhe ndërmjet LKA-së dhe LPK-së

LKA parasheh tri mjete juridike të jashtëzakonshme: 1) kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor; 2) kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, dhe 3) kërkesën për shqyrtim procedural. Dispozitat që rregullojnë shqyrtimin kundër vendimit të gjykatës ose vendimit përfundimtar janë në pjesën më të madhe identike me dispozitat e LPK-së. Megjithatë, sipas nenit 58 të LKA-së gjykata e cila e ka nxjerr vendimin përfundimtar po ashtu është kompetente të vendos për një kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm. Kjo ka mundur të jetë e duhur në një gjyqësor me një shkallë i cili ka ekzistuar deri me 2013 ndërsa Gjykata Supreme i ka shqyrtuar kontestet administrative si shkalla e parë dhe e fundit, por nuk është në përputhje me gjyqësorin me tri shkallë i cili është krijuar prej atëherë. Si rezultat, sipas dispozitave aktuale, Gjykata Supreme ka mandatin që të vendos për kërkesat për revizion në lëndët civile, por jo në çështjet administrative.

Një mospërputhje tjetër vërehet në afatet kohore për t'iu përgjigjur gjykatës. Në procedurën kontestimore afati është 15 ditë, ndërsa në kontestet administrative sipas LKA-së është 30 ditë. Kjo nënkupton se një organ administrativ (me një aparat profesional i cili duhet të jetë gjithmonë operacional) ka më shumë kohë që të përgjigjet se sa pala – që shpesh është një individ – në një kontest civil. Në fund kjo po ashtu do të ndikojë negativisht në kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave në lëndët e kontesteve administrative dhe do të zgjas kohën që i duhet një individ që të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të tij/saj. Për më tepër, Neni 37 (3) i LKA-së parasheh që gjykata duhet të përpiqet t'ia dërgojë ankesën të paditurit (organit publik) dy herë, nëse përpjekja e parë ka qenë e pasuksesshme. Duke pasur parasysh së lokacioni i organit publik duhet të theksohet në aktin e themelimit të organit dhe organi duhet të jetë operacional së paku 8 orë në të gjitha ditët e punës, është vështirë të kuptohet se si mund të dështojë krejtësisht një përpjekje për t'ia dorëzuar një dokument organit publik dhe pse dispozita të tilla – që përshkruajnë rregullat për përpjekjet e pasuksesshme për tua dërguar dokumentet organeve publike – duhet të ekzistojnë në ligjin që rregullon kontestet administrative. Në fund, dispozitat e tilla ofrojnë mundësi shtesë për organet publike që të mos respektojnë urdhrat e gjykatës dhe për zgjatjen e kohës që marrin procedurat ose për kufizimin e mundësive për konstatimin e të gjitha fakteve relevante të rastit.

Në fund, struktura e LKA-së nuk është në përputhje me standardet e aplikueshme për hartimin e akteve normative¹³. Disa nene kanë tituj, disa nuk kanë dhe nenet që rregullojnë materie të ngjashme (p.sh., nenet e përgjithshme, parashtrimi i ankesës, fazat e procedurës së gjykatës, etj.) nuk janë grupuar në kapituj në mënyrë që të rritet qartësia e përgjithshme e ligjit.

Mos-harmonizimi në mes të LKA-së dhe LPPA-së

LPPA parasheh mundësinë e parashtrimit të ankesës jo vetëm kundër një akti administrativ, por edhe kundër veprimeve administrative (përfshirë edhe mosveprimet) dhe kontratat administrative (shih nenin 136). Në të njëjtën kohë LKA siguron shqyrtim gjyqësor vetëm lidhur me ligjshmërinë e akteve administrative. Si rezultat shkalla e mbrojtjes gjyqësore në një procedurë administrative është më e ulët se sa shkalla e mbrojtjes së paraparë në LPPA.

Përveç kësaj, LPPA përmban dispozita që rregullojnë komunikimin elektronik në procedurën administrative (neni 117). LKA nuk parasheh një mundësi të tillë, edhe pse kjo mund të bënte komunikimin ndërmjet gjykatës dhe organeve administrative më efikas dhe më të shpejtë; duke shkurtuar kështu edhe kohën e procedurës së kontesteve administrative.

2.4. Ligjet dhe aktet nënligjore

Procedura në gjykatën administrative rregullohet me LKA, i cili drejtpërdrejtë mbulon dhe rregullon këtë fushë të drejtësisë, por edhe me ligje të tjera që ndikojnë në mënyrë të tërthortë në këtë fushë. Ato janë paraqitur në Aneksin 2.

2.5. Organet përgjegjëse për zbatimin e politikës aktuale dhe buxheti i tyre

¹³ Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2013 mbi standardet për hartimin e akteve normative

Organet përgjegjëse për menaxhimin dhe funksionimin e sektorit të drejtësisë administrative janë si vijon:

- 1) Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për hartimin e kornizës ligjore për procedurat gjyqësore dhe për organizimin e gjykatave;
- 2) Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor. Në këtë kontekst, funksionet e Këshillit përfshijnë procedurat e rekrutimit, emërimin, rrimërimin, transferimin, masat disiplinore, vlerësimin, ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë; menaxhimin dhe administrimin e gjykatës dhe zhvillimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit;
- 3) Akademia e Drejtësisë së Kosovës është përgjegjëse për trajnimin e gjyqtarëve dhe për trajnimin e kandidatëve për gjyqtarë;
- 4) Gjykata Themelore në Prishtinë është përgjegjëse për menaxhimin e DÇA-së, p.sh., për transferimin e gjyqtarëve nga departamentet e tjera në mënyrë që të reduktohet numri i lëndëve të vjetra, punësimin e stafit mbështetës e veçanërisht bashkëpunëtorëve profesionalë dhe sigurimin e vendeve të tjera të punës për mbështetje logjistike siç janë përkthyesit e gjykatave, etj;
- 5) DÇA është përgjegjës për gjykimin e lëndëve administrative në shkallën e parë;
- 6) Departamenti për Çështje Administrative në Gjykatën e Apelit është përgjegjës për të trajtuar ankesat kundër vendimeve të DÇA-së;
- 7) Gjykata Supreme është e autorizuar të vendos për mjetet juridike të jashtëzakonshme kundër vendimeve të DÇA-së;
- 8) Organet administrative të shkallës së dytë janë përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave kundër akteve administrative në kuadër të administratës.

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet e bëra në vitin paraprak	Buxheti i këtij viti	KASH për vitin që vjen
1. Buxheti i Gjykatës Themelore të Prishtinës	3,907,626	4,272,592	4,272,592
2. Buxhetet e tjera :			
2.1. Buxheti i Gjykatës së Apelit	1,126,158	1,308,398	1,308,398
2.2. Buxheti i Gjykatës Supreme	1,030,317	1,106,990	1,106,990
2.3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës	3,480,604	2,137,259	2,254,833
2.4. Akademia e Drejtësisë së Kosovës	570,384	663,884	664,906

2.6. Përvoja e vendeve të tjera në rajon

Pothuaj të gjitha vendet në rajon kanë sistem të specializuar të drejtësisë administrative në kuadër të gjyqësorit. Shumica e vendeve (i vetmi përjashtim është Bosnjë dhe Hercegovina) në rajonin e Ballkanit Perëndimor kanë krijuar gjykata të shkallës së parë të quajtura Gjykata Administrative të cilat gjykojnë ankesat kundër akteve administrative, veprimeve administrative, kontratave administrative dhe çështjeve të tjera të rregulluara me ligj. Në shumicën e vendeve numri i stafit mbështetës për gjyqtarët (përfshirë mbështetjen teknike dhe këshilltarët ligjorë) është 2-3 herë më i madh se sa numri i gjyqtarëve administrativë.

2.6.1. Shqipëria

Shqipëria ka miratuar Ligjin për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Kontestet Administrative në vitin 2012, me të cilin ajo themeloi gjykatën e specializuar administrative. Para këtij ligji, kontestet administrative zgjidheshin në seksionet administrative të Gjykatave të Qarkut, të cilat ishin të rregulluara si gjykime të veçanta në Kodin e Procedurës Civile.

Përveç themelimit të gjykatave administrative në nëntor 2013 (6 gjykata administrative të shkallës së parë në Bulqizë, Dibër, Krujë, Laç, Mat dhe Tiranë me 16 gjyqtarë, gjykata për masa administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ në Gjykatën Supreme), në procedurën administrative po ashtu kanë filluar të aplikohen edhe inovacione. Për shembull, barra për të dëshmuar ligjshmërinë e akteve administrative i është vënë administratës; së dyti, dështimi i paditësit që të paraqitet nuk është arsye për të mos mbajtur gjykimin. Ligji i ri përcakton afate specifike për paraqitjen e dëshmive dhe për veprimet përgatitore të procedurës së gjykatës.

Funksioni kryesor i Gjykatës Administrative është që të merret me kontestet që dalin nga:

- 1) zbatimi i akteve administrative dhe kontratave administrative;
- 2) kontestet që dalin nga ndërhyrja e paligjshme ose mosveprimi nga organi publik;
- 3) kontestet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative;
- 4) kontestet në fushën e marrëdhënieve të punës kur punëdhënësi është organ i administratës publike;
- 5) si dhe gjykimet për shqyrtimin e shkeljeve administrative të dënueshme me burgim deri në 30 ditë ose kërkesat për zëvendësimin e këtij dënimi.

2.6.2. Bosnjë dhe Hercegovina

Lëndët administrative trajtohen nga gjykatat e përgjithshme të cilat kanë juridiksion për vendimet e nxjerra nga organet administrative të nivelit shtetëror, entitetet dhe Distrikti i Bërçkos. Nuk është siguruar specializimi i gjyqtarëve në fusha të ndryshme të lëndëve administrative (p.sh., tatime, prokurim publik, ligje të ndërtimit), për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve në secilën njësi të gjykatës së përgjithshme.

Gjykata e shkallës së parë ka pasur një shkallë të përgjithshme të zgjidhjes së lëndëve prej 91%, që nënkupton se është duke pasur një rritje të lehtë të numrit të lëndëve të vjetra. Po ashtu, numri i lëndëve të pazgjidhura për gjyqtar në fund të vitit 2014, i llogaritur për të gjitha gjykatat në vend, është i lartë (165 lëndë për gjyqtar). Kjo ngrit shqetësimin rreth kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore. Niveli i besimit në gjykata është i ulët (35.3% në vitin 2014). Në anën tjetër, përqindja e vendimeve të shkallës së parë të shfuqizuar ose ndryshuar nga gjykatat e apelit (zakonisht të përdorura si indikator të cilësisë së vendimeve gjyqësore) është 22 %.

2.6.3. Sllovenia

Sllovenia ka miratuar Ligjin për Kontestet Administrative në vitin 1997. Para vitit 1997, Gjykata Supreme ka qenë përgjegjëse për kontestet administrative. Një Gjykatë e re Administrative e specializuar u themelua me seli në Lubljanë dhe me tri njësi të gjykatës në Celje, Maribor dhe Nova Gorica. Në vitin 2006 u miratua një Ligj i ri për Kontestet Administrative¹⁴ dhe filluan të aplikohen një varg risish.

Në një kontest administrativ, Gjykata vendos për ligjshmërinë e akteve të plotfuqishme administrative të cilat prekin statusin ligjor të paditësit dhe për ligjshmërinë e akteve të tjera, vetëm nëse është e përcaktuar me ligj. Gjykatat gjykojnë vetëm në çështjet e ligjshmërisë së akteve dhe veprimet individuale. E drejta e ankesës është e kufizuar. Ankesat kundër vendimeve të Gjykatës administrative në Gjykatën Supreme lejohen vetëm nëse Gjykata Administrative ka vendosur për meritat [e lëndës] në kontestin me juridiksion të plotë.

Aktualisht në Gjykatën Administrative janë të punësuar 27 gjyqtarë dhe 44 anëtarë të stafit administrativ. Në vitin 2015 gjykata ka pranuar 5222 kërkesa; në fillim të periudhës kanë qenë 1724 lëndë të vjetruara. Në vitin 2015 gjyqtarët kanë zgjidhur 5301 lëndë, që nënkupton një shkallë të zgjidhjes prej më shumë se 108%.¹⁵

2.6.4. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM)

IRJM ka krijuar një sistem të ri të drejtësisë administrative në vitin 2006 kur është themeluar Gjykata Administrative. Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative krijuan një sistem të drejtësisë administrative me dy shkallë. Sistemi klasik i apelit është krijuar në vitin 2010, para të cilit gjykatë e shkallës së dytë ishte Gjykata Supreme. Gjykata Administrative ka 29 gjyqtarë, 19 bashkëpunëtorë profesionalë dhe 48 anëtarë të stafit administrativ. Gjykata gjykon paditë kundër akteve administrative individuale ose akteve të tjera ligjore individuale e po ashtu edhe çështjet e kundërvajtjeve. Çdo vit pranohen mbi 11000 lëndë, në dy vitet e fundit

¹⁴ Zakon o upravnem sporu, Gazeta Zyrtare, 105/06

¹⁵ http://www.sodisce.si/usrs/osnovne_informacije_o_sodiscu/seznam_strateskih_in_programskih_dokumentov

shkalla e zgjidhjes [së lëndëve] në gjykatën administrative të shkallës së parë është mbi 110%. Mbi 10000 lëndë janë të vjetruara që presin zgjidhjen. Gjykata e Lartë Administrative si gjykatë e shkallës së dytë ka 9 gjyqtarë dhe 12 anëtarë të stafit administrativ. Për pothuaj 15 % të vendimeve të shkallës së parë bëhen ankesa në gjykatën më të lartë.

Kundërvajtjet janë subjekt i kontesteve administrative. Së paku 40% e të gjitha lëndëve janë padi kundër organeve shtetërore të cilat janë kompetente për të shqiptuar gjoha ose masa të tjera për kundërvajtje.

2.6.5. Republika e Serbisë

Gjykata Administrative ka filluar të funksionojë me 1 janar 2010 dhe është themeluar si gjykatë me juridiksion të veçantë. Selia e Gjykatës është në Beograd. Tri njësitë e gjykatës jashtë selisë së gjykatës gjenden në Kragujevc, Novi Sad dhe Nish. Organizimi i brendshëm dhe puna e Gjykatës Administrative rregullohet me Ligjin për Gjyqtarët, Ligjin për Organizimin e Gjykatave dhe Rregulloren e Gjykatës.

Gjykata Supreme e Kasacionit vendos për ankesat kundër vendimeve të nxjerra nga Gjykata Administrative. Një kontest administrativ mund të iniciohet kundër çdo akti administrativ të nxjerr gjatë procedurës në organin administrativ të shkallës së dytë dhe kundër një akti administrativ të shkallës së parë për të cilin nuk ka të drejtë ankese brenda administratës.

Gjykata Administrative funksionon me 38 gjyqtarë. Gjyqtarët e Gjykatës Administrative janë të ndarë në panele brenda selisë së gjykatës dhe njësite të gjykatës sipas kalendarit vjetor të detyrave. Gjyqtarët mbështeten nga 53 këshilltarë dhe 72 anëtarë të stafit administrativ. Në vitin 2015 gjykata ka pranuar 20315 padi. Numri i përgjithshëm i lëndëve të pazgjidhura është 44577. Shkalla e zgjidhjes së lëndëve në vitin 2015 ishte 92%.

2.6.6. Mali i Zi

Në vitin 2003 u themelua një gjykatë e specializuar administrative e cila filloi punën me 1 janar 2004. Gjykata filloi me 1200 lëndë të cilat u transferuan nga Gjykata Supreme. Gjykata Administrative ka 12 gjyqtarë, 10 bashkëpunëtorë profesionalë dhe 33 anëtarë të stafit mbështetës. Ligji për Konfliktet Administrative rregullon pothuaj të gjithë hapat e procedurës gjyqësore dhe në një numër të kufizuar të çështjeve përdoret Ligji për Procedurën Civile. Palët nuk kanë të drejtë ankese. Gjykata Supreme gjykon vetëm në rastet e mjetit juridik të jashtëzakonshëm.

Në fillim të vitit 2015 gjykata kishte 1813 lëndë të pazgjidhura. Gjatë vitit 2015 gjykata ka pranuar 3689 padi të reja. Shkalla e zgjidhjes [së lëndëve] ishte 90.5%.

2.7. Përmbledhje e problemeve aktuale në Kosovë

Në Kosovë si rezultat i kësaj analize janë identifikuar problemet në vijim. Ato grupohen në katër grupe kryesore.

2.7.1. Problemet lidhur me kapacitetet që rezultojnë në kohëzgjatjen e madhe të procedurave

- 1) Numri i madh i lëndëve të vjetra administrative në DÇA – bazuar në dinamikën aktuale për zgjidhjen e lëndëve del se gjykatës do t'i duhen më shumë se dy vjet për të zgjidhur të gjitha lëndët që janë aktualisht lëndë të vjetra nëse nuk vjen asnjë lëndë tjetër e re. Si rezultat i lëndëve të vjetra, kohëzgjatja mesatare e procedurave bazuar në metodën e llogaritjes së kohës për zgjidhjen [e lëndëve] është 818 ditë;
- 2) SAO nuk është në gjendje të sigurojë që të gjitha dokumentet dhe të dhënat e nevojshme për gjykimin e lëndës do të paraqiten në gjykatë sipas kërkesës;
- 3) Pamundësia e shërbimit postar t'ua dërgojë dokumentet organeve publike;
- 4) Metodrat e brendshme të punës së DÇA-së dhe Gjykatës Themelore dhe mos-fleksibiliteti në ofrimin e mbështetjes teknike për gjyqtarët (p.sh. përkthyesit dhe referentët e gjykatës) rezultojnë në shtyrje të seancave dhe shkakton vonesa në trajtimin e lëndëve;
- 5) Krahasuar me vendet e tjera në rajon, gjyqtarët në DÇA nuk kanë staf mbështetës të mjaftueshëm, si rezultat, gjyqtarët janë të stërngarkuar me punë administrative dhe kanë më pak kohë për gjykim;

2.7.2. Korniza ligjore nuk e mbështet procedurën efikase dhe efektive

- 6) Dispozitat e LKA-së nuk e obligojnë gjykatën të konstatojë të gjitha faktet e lëndës me iniciativën e vet nëse është e nevojshme dhe nuk sigurojnë ekzekutimin e duhur dhe me kohë të vendimeve të gjykatës, kjo rezultojnë në lojën pingpong me lëndët sepse individëve u duhet të parashtrijnë ankesa të reja në gjykatë pasi që vendimet fillestare të gjykatës nuk sigurojnë mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre;
- 7) Mospërputhjet në përkufizimet e lëndës administrative lidhur me kontestet kundër akteve administrative të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
- 8) Me zbatimin e Ligjit për Kundërvajtje DÇA do të vërshohet me ankesa kundër gjobave/ndëshkimeve monetare të shqiptuara nga administrata edhe pse ligji nuk u jep atyre mandatin për tu marrë në mënyrë efektive me këto ankesa dhe ankesat për lëndët e tjera të kundërvajtjes trajtohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore. Kjo minon specializimin e gjyqtarëve të DÇA-së në kontestet administrative dhe i detyron ata të fokusohen në trajtimin e një numri shumë të madh të kundërvajtjeve në vend të ankesave kundër vendimeve të marra si rezultat i procedurave administrative (të cilat mund të konsiderohen si lëndë të vërteta administrative);
- 9) Mospërputhjet në kornizën ligjore e komplikojnë punën e gjyqtarëve dhe rrisin kohën që duhet për gjykimin e një kontesti administrativ – gjyqtarët duhet të punojnë paralelisht me dy kode të procedurës;

10) Dispozitat e LKA-së mundësojnë dorëzimin joefikas të dokumenteve – afatet për t'iu përgjigjur gjykatës janë më të gjata për organet publike se sa për pjesëmarrësit në procedurat civile, organet publike kanë mundësi ligjore të shmangin dorëzimin e dokumenteve, komunikimi elektronik me organet publike nuk lejohet në ligj;

11) Tepër shumë mundësi të obligueshme për tu ankuar brenda administratës kundër vendimeve administrative që zgjasin kohën që duhet për të arritur në vendimin përfundimtar në një lëndë dhe që kërkojnë resurse nga shteti dhe pjesëmarrësit në procedurë pa sjell vendime cilësore;

2.7.3. Problemet lidhur me qasjen në drejtësi

12) Dispozitat e LKA-së sipas të cilave shpenzimet e procedurës barten vet nga të dyja palët pavarësisht rezultatit të procedurës, kufizojnë seriozisht qasjen në drejtësi;

13) Sipas LKA-së asnjë mbrojtje gjyqësore nuk ofrohet kundër veprimeve të paligjshme administrative dhe mosveprimit, përderisa LPPA që do të hyjë në fuqi së shpejti ofron mundësi ankimi në të dy rastet;

2.7.4. Mosbesimi në gjyqësor

14) Sipas anketës Barometri i Ballkanit vetëm 31% e popullsisë së Kosovës ka besim në gjykata dhe në gjyqësor.

Kapitulli 3: Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i përgjithshëm i këtij koncept dokumenti është të përshkruajë masat rregullative dhe jo-rregullative që do të ndihmojnë në krijimin e një sistemi të drejtësisë administrative, i cili siguron trajtim të drejtë, është i qasshëm, efikas dhe në gjendje të gjykojë lëndët brenda një kohe të arsyeshme. Tri objektivat kryesore bazuar në tri grupet kryesore të problemeve janë:

1) Zvogëlimi i lëndëve të vjetra administrative deri në fund të 2020 në nivelin ku lëndët e vjetra administrative (duke përjashtuar ankesat për kundërvajtje pasi që ato nuk duhet të mbahen nën kompetencën e gjyqtarëve administrativë) nuk do të jenë më shumë se numri i lëndëve administrative që gjykohen çdo vit (sipas të dhënave për 2020). Në këtë mënyrë koha e llogaritur për zgjidhjen e lëndëve administrative nuk do të jetë më shumë se 365 ditë;

2) Përcaktimi i mandatit të qartë të gjykatës dhe obligimit për të konstatuar të gjitha faktet e lëndës gjatë procedurës (me iniciativën e vet) në mënyrë që të marrë një vendim real në të gjitha lëndët dhe që 99% e vendimeve të gjykatës të ekzekutohen nga administrata brenda periudhës së kërkuar kohore;

3) Heqja e barrierave ekzistuese financiare dhe ligjore të cilat kufizojnë qasjen në drejtësinë administrative, përfshirë mosharmonizimin me LPPA-në.

Kapitulli 4: Përmbledhje e opsioneve

Tabela në Aneksin 1 përfshinë një përshkrim të opsioneve për adresimin e 14 problemeve kryesore të gjendjes aktuale të përshkruar në Kapitullin 2. Tabela do të përfshijë tri opsione për zgjidhjen e secilit problem: opsioni për të mos bërë asgjë, opsioni rregullativ dhe opsioni për sigurimin e resurseve shtesë. Opsioni(et) e preferuara – lidhur me efektivitetin ose efikasitetin në zgjidhjen e problemit – shënohet me shkronja të theksuara të zeza (bold).

Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)

Sipas Opsionit të parë nuk do të ketë asnjë ndryshim.

Do të vazhdojnë problemet me efikasitetin e gjykatave, në mos do të përkeqësohen edhe më tepër për shkak të numrit të lëndëve të reja që pritet të pranohen në veçanti lëndëve kundërvajtëse që pas 1 janarit 2017 pritet të pranojë Departamenti për Çështje Administrative. Numri i lëndëve të vjetra mbetet ashtu si është, besimi i publikut në gjyqësor do të bie, qytetarët nuk do tu drejtohen gjykatave për mbrojtje kundër administratës, ndërsa administrata do të bëhet më pak llogaridhënëse, më pak efektive dhe shumë e kushtueshme. Ligji për konfliktet administrative ekzistues nuk i ndjek zhvillimet e reja dhe drejtimit në organizimin e mbrojtjes gjyqësore kundër veprimeve të paligjshme nga ana e administratës. Ligji nuk ka rregullat e nevojshme për zhvillimin e procesit të konfliktit administrativ, por bazohet në dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore, zbatimi i të cilave në shumë raste shkakton probleme dhe zvarritje të procedurës. Vazhdimi me këtë sistem do të mundësojë vazhdimin me pingpong të rasteve, gjyqtarët do të vazhdojnë të punojnë me dy ligje të procedurës.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Shkurt, opsionet e preferuara parashohin zbatimin e këtyre 10 hapave të mëposhtëm (me disa nën-hapa):

1. Zhvillimi i një Ligji të ri për Kontestet Administrative, i cili do të rregullojë tërë procedurën administrative dhe do t'i referohet LPK-së për çështjet që do të aplikohen pothuaj në mënyrë të ngjashme në të dy procedurat (nëse ekzistojnë çështje të tilla). Në mënyrë specifike, ligji i ri do të përmbajë këto dispozita:

1.1. Obligimin e gjykatës për të konstatuar faktet e lëndës me vet iniciativën e saj;

1.2. Të drejtën e mbrojtjes gjyqësore kundër veprimeve administrative të paligjshme dhe mosveprimit;

- 1.3. Mbrojtjen gjyqësore të së drejtës objektive ndaj akteve nënligjore të organeve publike (legjitimiteti, kompetenca, afatet);
 - 1.4. Të drejtën e gjykatës që të shqiptojë gjobë kundër një pjesëmarrësi, nëse ai nuk respekton urdhrat e gjykatës gjatë procedurës ose gjatë ekzekutimit të vendimit;
 - 1.5. Shpenzimet e gjykatës (taksa, shpenzimet lidhur me përfaqësimin, etj.) të palës ankuese do të barten nga i padituri, nëse ankesa aprovohet nga gjykata (brenda kufirit të arsyeshëm të përcaktuar me ligj ose nga gjykata në secilin rast individual);
 - 1.6. Obligimin e gjykatës dhe organeve publike të komunikojnë në mënyrë elektronike me njëra-tjetrën;
 - 1.7. Mundësinë që këshilltarët ligjorë të nënshkruajnë dokumentet e gjykatës dhe urdhrat procedural të ndërmjetëm kundër të cilëve nuk mund të bëhet ankesë;
 - 1.8. Afatin maksimal prej 15 ditësh për organet publike që të përgjigjen në kërkesat e gjykatës;
 - 1.9. Vendimi përfundimtar (pasi të jenë shteruar të gjitha mundësitë ankimore) do të publikohet në internet. Pala ankuese mund të kërkoj heqjen e të dhënave personale të tij/saj nga vendimi para publikimit;
2. Ndryshimi i Ligjit për Gjykatat në mënyrë që ankesat kundër akteve dhe veprimeve administrative të LKA-së do të jenë nën kompetencën e DÇA-së;
 3. Ndryshimi i Ligjit për Kundërvajtje në mënyrë që ankesat kundër vendimeve për kundërvajtje do të duhet të parashtrihen në të njëjtin departament në gjykatën themelore që merret me lëndët e kundërvajtjes po ashtu edhe si organ gjyqësor i shkallës së parë;
 4. Ndryshimi i LPPA-së në mënyrë që ankesa administrative të jetë e obligueshme vetëm në fusha të zgjedhura (p.sh., prokurim publik) ku filtri i zgjidhjes së kontesteve në procedurë jo-gjyqësore mund të funksionojë në mënyrë efektive dhe efikase, duke zvogëluar kështu numrin e ankesave që parashtrihen në gjykatë dhe duke ofruar qasje më të shpejt në drejtësi se sa do të mund të ishte e mundur përmes gjykatës. Ankesat në fushat e tjera administrative mund të mbesin vetëm si opsion jo i obligueshëm para se të adresohen në gjykatë;
 5. Krijimi i posteve shtesë të gjyqtarëve në DÇA (duke ri-alokuar poste gjyqësore nga departamentet e përgjithshme të gjykatave themelore të cilët më përpara janë marrë me kundërvajtje) në mënyrë që të arrihet normalizimi i lëndëve të vjetra (backlog) administrative deri me 2020. Pasi të jetë normalizuar numri i lëndëve të vjetra (backlog) (koha e llogaritur për zgjidhjen e lëndëve është më pak se 365 ditë), është e mundur të vlerësohet (bazuar në numrin e lëndëve të reja që vijnë) se a mund të zvogëlohet numri i pozitave gjyqësore (p.sh., duke mos zëvendësuar gjyqtarët që dalin në pension me gjyqtarë të ri) ose nëse duhet të mbahen ata;
 6. Krijimi i posteve të këshilltarëve ligjorë – të paktën 1 këshilltar për 2 gjyqtarë – në mënyrë që të minimizohet kryerja e detyrave jo-gjyqësore nga gjyqtarët, të ulët ngarkesa me punë e gjyqtarëve dhe të bëhet gjykata të funksionojë në mënyrë më efikase;

7. Ofrimi i trajnimit për gjyqtarët dhe këshilltarët ligjorë për ndryshimet rregullative, kryesisht për Ligjin e ri për Kontestet Administrative;

8. Mbështetja e fleksibilitetit dhe aftësisë për tu përgjigjur kërkesave të përditshme në organizimin e brendshëm të DÇA-së. Aplikimi i një kalendari për rezervimin e resurseve të përkthyesve (bazuar në të dhënat në dispozicion lidhur me pjesëmarrësit e ftuar në seanca) në mënyrë që të shmangen mbivendosjet dhe shtyrjet e seancave për shkak të mungesës së përkthyesit. Aplikimi i një sistemi për zëvendësimin e përkohshëm të stafit mbështetës në mënyrë që gjatë çdo pushimi vjetor/pushimi me leje të jetë i caktuar zëvendësimi.

9. Ofrimi i resurseve shtesë për trajnim dhe pajisje shtesë për shërbime postare në mënyrë që ata të jenë më të familjarizuar me emrat e ri të rrugëve.

10. Ofrimi i resurseve shtesë për trajnimin e organeve administrative për të rritur cilësinë e vendimeve dhe veprimeve të tyre.

Si rezultat i masave të propozuara, gjyqtarët administrativë do të jenë në gjendje të vendosin për lëndën e kontesteve administrative pa i marrë përsipër përgjegjësitë e pushtetit ekzekutiv. Ata do të kenë instrumentet për të urdhëruar organet publike që të përgjigjen në kërkesat e gjykatës për të dhëna dhe dokumente të cilat nevojiten për konstatimin e fakteve të një lënde. Me këto masa – si dhe me trajnim shtesë – do të rritet llogaridhënia dhe efikasiteti i administratës.

Me resurse shtesë (përfshirë gjyqtarët dhe këshilltarët ligjorë) dhe me procedura më efektive si dhe me organizim të brendshëm do të zvogëlohet numri i lëndëve të vjetra administrative. Shpenzimet shtesë të paktën pjesërisht mund të financohen duke ri-alokuar resurset brenda gjyqësorit (nga departamentet që janë marrë me kundërvajtje ku autoriteti vendimmarrës u ishte deleguar organeve administrative) ose nga ri-alokimi i resurseve nga organet administrative të apelit të cilat nuk do të mbesin si të obligueshme dhe do të kenë më pak lëndë. Gjyqtarët administrativë do të jenë në gjendje të specializojnë në konteste të pastra administrative dhe do të rritet cilësia e vendimeve.

Njerëzit do të kenë qasje më të madhe në gjykatë pasi që shpenzimet e gjykatës do të barten nga shteti, kur gjykata vendos në favor të parashtruesit. Po ashtu mbrojtja gjyqësore kundër akteve dhe veprimeve të paligjshme të administratës do të jetë në përputhje me mbrojtjen e ofruar në procedurat administrative të apelit/ankesës. Transparenca e gjyqësorit do të rritet përmes publikimit të të gjitha vendimeve përfundimtare në lëndët administrative dhe me këtë shpresohet se do të rritet edhe besimi i qytetarëve në gjyqësor.

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Përmes këtij opsioni do të tentohet të ndryshohet vetëm qasja në zbatimin e ligjit për konfliktet administrative dhe legjislacionit aktual për gjyqësinë administrative në përgjithësi.

Ndryshimi vetëm në qasjen e zbatimit të Ligjit ekzistues për konfliktet administrative pa ndryshimin e ligjit, nuk do të mund të ndikojë në arritjen e objektivit kryesor të këtij koncepti dokumenti për rritjen e efikasitetit, sepse nuk mund të zbatohen ndryshe dispozitat e përcaktuara shprehimisht me ligjin aktual. Për më tepër, ligji aktual ka një numër të konsiderueshëm të

zbrazëtime dhe paqartësi të ligjore, të cilat nuk do të mund të zbatoheshin ndryshe me qëllim të evitimit të vonësive në procedim, shtyerjeve të seancave, ping-pong të rasteve e për pasojë shkeljen e të drejtave të qytetarëve për gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme për gjykim.

Asnjë alternativë tjetër qofshin ato trajnime apo edhe rritje e buxhetit nuk mund të ndikonin në rritjen e efikasitetit të gjykatave vetëm përmes ndryshimit të qasjes ekzistuese të zbatimit.

Pa ndryshimin e ligjit për konfliktet administrative nuk do të mund të zbatoheshin ndryshe dispozitat e parapara shprehimisht në ligjin aktual për konfliktet administrative si dhe nuk do të mund të plotësoheshin zbrazëtitë e shumta të ligjit aktual.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Shiko Aneksin 1.

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Në këtë pjesë të Koncept Dokumentit do të shohim se cilat janë përfitimet dhe mangësitë e opsioneve të lartpërmendura.

Megjithatë duhet pranuar se nuk është e mundur të vlerësohen me saktësi të gjitha përfitimet, pasojat negative dhe kostoja e opsioneve, mirëpo përmes analizës së informatave në dispozicion dhe konsultimit me grupet e prekura, do të provojmë të identifikojmë përfitimet dhe mangësitë kryesore.

Përfitimet

1. Sa i përket opsionit të parë, pra ruajtjes së status quo-së, përfitimi kryesor nga ky opsion është ruajtja e kohës për momentin pa pasur nevojë për procesin e përpilimit dhe miratimit të Ligjit të ri për konfliktet administrative.
2. Sa i përket opsionit të dytë, pra miratimit të një ligji të ri për konfliktet administrative, konsiderohet zgjidhja më e mirë e cila siguron zgjidhje afatgjatë dhe të qëndrueshme, përmes të cilës do të adresoheshin edhe të gjitha çështjet e identifikuar.
3. Sa i përket opsionit të tretë, përfitimi mund të jetë minimal, përmes ndryshimit të qasjes në zbatim të ligjit për konfliktet administrative, pasi që ky opsion nuk siguron zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë, ngase nuk mund të adresohen me ndryshim të qasjes shumica e çështjeve të identifikuar.

Pasojat negative

1. Sa i përket opsionit të parë, pra ruajtjes së status quo-së, pasoja negative kryesore nga ky opsion është vazhdimi i mosefikasitetit të gjykatës për shkak të numrit të madh të lëndëve dhe numrit të vogël të gjyqtarëve dhe stafit administrativ. Po ashtu mospërcaktimi i rregullave të veçanta të procedurës për konfliktet administrative me ligjin aktual, dhe nevoja për zbatim të Ligjit për procedurën kontestimore po shkakton zvarritje të procedurës.
2. Sa i përket opsionit të dytë, pra hartimi dhe miratimit të Ligjit të ri për kontestet administrative, pasojë do të jetë koha që do të kalohet në hartimin e ligjit të ri.
3. Sa i përket opsionit të tretë, pasojë negative do të jetë caktimi i buxhetit shtesë në mënyrë që të adresohen çështjet e identifikuar, ndërkohë që numri më i madh i këtyre shqetësimeve nuk mund të adresohet vetëm përmes shtimit të buxhetit dhe ndryshimit të qasjes në zbatim të ligjit aktual.

Efekti shpërndarës

Gjithashtu, sa i përket efektit shpërndarës, në kuptimin e ndryshimit të përfitimeve dhe pasojave negative në aspektin e rajoneve të ndryshme ose zonave rurale apo urbane, nuk mund të përcaktohet me saktësi efekti shpërndarës në këtë fazë.

Përmbledhjen e vlerësimit të ndikimit financiar

Për zbatimin e plotë të Ligjit për konfliktet administrative do të jenë përgjegjës Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Propozimet të cilat do të ndikojnë në shpenzimet e organeve përkatëse përfshijnë krijimin e pozitave shtesë gjyqësore si dhe pozitat e këshilltarëve ligjorë të DÇA, shpenzimet e trajnimeve shtesë për gjyqtarët, këshilltarët ligjorë dhe sekretarët juridikë të gjykatave, si dhe shpenzimet që lidhen me shpenzimet e trajnimeve për shërbyesit civilë (në mënyrë që të jenë më të përgatitur për të marrë vendime të ligjshme administrative).

Paga mujore e gjyqtarit është 1,030 Euro, paga vjetore e pozitës së një gjyqtari është 12,360 Euro. Paga vjetore e një sekretare juridikë është 4,200 Euro (paga mujore është 348.56 Euro). Të paktën përkohësisht – me qëllim të zvogëlimit të lëndëve të grumbulluara deri në vitin 2020 siç është edhe objektiva për të përballuar numrin e rritjes së lëndëve hyrëse, për shkak të qasjes më të mirë në drejtësi e cila do të arrihet përmes miratimit të LKA të ri – numri i gjyqtarëve në Departamentin për Çështje Administrative duhet të rritet edhe me shtatë pozita shtesë (në këtë mënyrë numri i përgjithshëm i gjyqtarëve në DÇA do të dyfishohet). Kjo gjithashtu nënkupton numrin shtesë prej shtatë sekretarëve juridikë. Përveç kësaj, 7 pozita shtesë duhet të krijohen në DÇA për këshilltarët ligjorë me një pagë deri në 75% të asaj të gjyqtarit.

Shpenzimet e përgjithshme vjetore që lidhen me krijimin e pozitave tjera do të jenë 180,810 Euro (rreth 4.2% e buxhetit aktual të Gjykatës Themelore të Prishtinës).

Lloji i pozitës shtesë	Numri i pozitave shtesë	Paga vjetore (EUR)	Gjithsej shpenzime vjetore(EUR)
Gjyqtari	7	12360	86,520
Zyrtar Ligjor	7	9270	64,890
Referent/Procesmbajtës	7	4200	29,400
Totali			180,810

Shpenzimet e përgjithshme vjetore që lidhen me krijimin e pozitave tjera do të jenë 180,810 Euro (rreth 4.2% e buxhetit aktual të Gjykatës Themelore të Prishtinës). Shuma shtesë prej 60,000 Euro (rreth 20% të pagave të tyre vjetore) duhet të ndahet për trajnimin e gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë të DÇA (për trajnime në LKA re dhe në parimet e mbrojtjes gjyqësore efektive në kontestet administrative). Të paktën 100,000 Euro duhet të ndahen çdo vit në IKAP për trajnimin e nëpunësve civilë për procedurat administrative.

Ndikimi në buxhetin e përgjithshëm të shtetit dhe buxhetin e gjyqësorit varet se sa burime mund të rialokohen nga departamentet e gjykatave themelore që merren me lëndë të kundërvajtjeve (të cilat duhet të jenë në gjendje për të përballuar në mënyrë të konsiderueshme me më pak burime, pasi që një pjesë e madhe e punës së tyre i është deleguar organeve administrative) dhe nga organet e shkallës së dytë administrative (të cilat nuk funksionojnë në mënyrë efikase, nuk përgatisin vendime me cilësi të mirë dhe nuk janë në gjendje për të ulur në mënyrë të konsiderueshme numrin e lëndëve që vijnë për DÇA). Me qëllim të financimit të krijimit të pozitave shtesë (180,810 Euro) duke shpërndarë burimet nga departamentet që merren me kundërvajtje, numri i gjyqtarëve në këto departamente do të duhet të jenë të zvogëluar për 15 pozita. Kjo do të lirojë 185,400 Euro nga buxheti i këtyre departamenteve vetëm në bazë të pagave gjyqësore, për më tepër shpenzimet për nëpunësit në departamentet e tjera gjithashtu mund të zvogëlohen. Nëse të gjitha këto pozita nuk janë të lira, disa nga gjyqtarët ekzistues dhe nëpunësit nga departamentet që merren me kundërvajtje mund të transferohen në DCA. Lokalet për pozitat e reja gjithashtu mund të rialokohen nga gjykata e (nga departamente ku numri i gjyqtarëve dhe sekretarëve juridikë është zvogëluar).

Në këtë mënyrë ndryshimet mund të financohen në kuadër të buxhetit të gjyqësorit. Rialokime të ngjashme mund të bëhen në nivel të Gjykatës së Apelit, për shkak se numri i lëndëve të pranuar në Gjykatën e Apelit mund të rritet, në qoftë se rritet numri i lëndëve të pranuar në gjykatën e shkallës së parë që merret me çështje administrative.

Si rezultat, bartjen e tërë koston për reformën në gjyqësinë administrative e bartë buxheti i Republikës së Kosovës, ndërsa sa i përket fushatës së informimit publik pritet përkrahje nga komuniteti i donatorëve në Kosovë.

Ky Koncept Dokument ka kosto shtesë që i parasheh opinionin për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria Financa të bashkangjitur këtij dokumentit.

Kapitulli 7: Konsultimi

Që në fazat e hershme të hartimit të këtij koncept dokumentit janë përfshirë ekspertët si vendor ashtu edhe ndërkombëtar. Para se të filloj formalisht hartimi i këtij koncept dokumenti MAP ka mbajtur dy tryeza të rrumbullakëta për të diskutuar për problematikat e drejtësisë administrative me institucionet kyçe duke përfshirë: Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin gjyqësor të Kosovës, Avokatin e Popullit, KPMSHCK, gjyqtarët e Gjykatës Themelore dhe të Apelit (që janë të ngarkuar me çështje administrative), shoqërisë civile (GLPS), ekspertët e SIGMA/OECD.

7.1. Konsultimi me ekspertë (jashtë Qeverisë)

7.2. Konsultimi me ministrinë e tjera

7.3. Konsultimi me akterët – organizatat ose individët që ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë

7.4. Konsultimi me publikun dhe shoqërinë civile

Për pikat 7.1, 7.2, 7.3 dhe 7.4 të bashkangjitur gjeni raportin e konsultimeve paraprake dhe publike.

Kapitulli 8: Rekomandimi

Rekomandim i Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Drejtësisë është që Koncept Dokumenti të miratohet nga Qeveria me qëllim që sa më parë të korrigjohen të metat si dhe të evitohen vështirësitë dhe pengesat që janë paraqitur gjatë zbatimit në praktikë të Ligjit për konfliktet administrative. Opsioni i rekomanduar në këtë Koncept Dokument është opsioni 2, nxjerrja e Ligjit të ri për konfliktin administrativ, ndryshimi i Ligjit për gjykatat, Ligjit për kundërvajtjet, krijimi i posteve shtesë të gjyqtarëve në DÇA, krijimi i posteve të këshilltarëve ligjorë, ofrimi i trajnimeve për gjyqtarët dhe këshilltarët ligjorë, ofrimi i resurseve shtesë për trajnimin e organeve administrative për të rritur cilësinë e vendimeve dhe veprimeve të tyre. Ky opsion mundëson adresimin e shqetësimeve të identifikuara nga gjykatat dhe institucionet tjera relevante. Përfitim tjetër i madh nga ky rekomandim, do të jetë edhe reflektimi pozitiv i Raportit të Komisionit Evropian për Kosovës pas hyrjes në fuqi dhe fillimit të zbatimit të ligjit për konfliktet administrative.

Në rast të miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Drejtësisë do të filloj me përgatitjet për hartimin e Ligjit të ri për konfliktet administrative, të cilin do ta dërgoj në Qeveri për procedim të mëtejshëm.

Të gjitha këto ndryshime do të arrihen brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri.

Kapitulli 9: Komunikimi

Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Drejtësisë do të jetë e përqendruar në ofrimin e informacioneve lidhur me detajet e procesit të plotësim dhe ndryshimit, ku do të merren parasysh konsultimet me ekspertët në fushën përkatëse si dhe konsultimi me akterët relevantë dhe shoqërinë civile. Komunikimi do të realizohet duke zbatuar qasjen gjithëpërfshirëse të të gjithë akterëve relevantë përmes tryezave të rumbullakëta, takimeve të ndryshme, etj.

Aneksi 1. Përmbledhja e opsioneve për zgjidhjen e problemeve ekzistuese

Problemi	Shkaqet	Opsioni 1: status quo	Opsioni 2: rregullativ	Opsioni 3: jo-rregullativ
1. Kohëzgjatja e procedurave	1.1. Lëndët e vjetra (backlog)	Të mos bëhet asgjë: numri i lëndëve të vjetra mbetet ashtu siç është; besimi i publikut në gjyqësor do të bie; administrata do të bëhet më pak llogaridhënëse, më pak efektive dhe shumë më e kushtueshme.	Sigurimi i resurseve shtesë bashkë me ndryshimet rregullative dhe jo-rregullative (shih nën 1.2., 1.3., 1.4., 1.5., 2.1.,), që ndihmojnë në përshpejtimin e procesit.	Sigurimi i resurseve shtesë: krijimi i pozitave shtesë për gjyqtarë. Gjykatat mund të zgjidhin më shumë lëndë, por pa ndryshimet e duhura rregullative do të bëhen më pak efektive, opsioni kushton më shumë para se sa që është e arsyeshme. Sigurimi i trajnimit shtesë të gjyqtarëve për ndryshimet rregullative.
	1.2. Autoritetet shtetërore nuk paraqesin dokumentet me kërkesën e gjykatës	Të mos bëhet asgjë: gjendja mbetet e njëjtë siç është; organet publike paraqesin dokumentet e kërkuara dhe paraqiten në gjykatë me vullnetin e tyre.	Ndryshimi rregullativ: nëse organi publik akti ose veprimi i të cilit është kontestuar në gjykatë nuk i paraqet të dhënat ose dokumentet e kërkuara, gjykata mund të shqiptojë një gjobë kundër atij organi (e cila paguhet nga buxheti i atij organi).	Sigurimi i resurseve shtesë për SAO dhe ata bëhen përgjegjës për mbledhjen e të gjitha dokumenteve të nevojshme për të gjitha lëndët: mund të jetë efektive dhe organi që është paditur nuk mbahet përgjegjës.
	1.3. Problemet me dërgimin e dokumenteve	Të mos bëhet asgjë: postierët gradualisht do të mësojnë emrat e rinj të rrugëve dhe do jenë në gjendje të dërgojnë dokumentet më me efikasitet	Ndryshimi rregullativ: krijimi i komunikimit të detyrueshëm elektronik me organet publike (të cilat sidoqoftë duhet të kenë adresa të emailit).	Sigurimi i resurseve shtesë për trajnime dhe pajisje (d.m.th. telefona me harta të Google-s (Google Maps) të shërbimeve postare në mënyrë që ata të familjarizohen më shumë me emrat e rinj të rrugëve
	1.4. Rregullat jofleksibile të brendshme për rialokimin e stafit në DÇA	Të mos bëhet asgjë: secili gjyqtar/e do të ketë stafin e vet mbështetës, secili departament do të ketë përkthyesit e vet	Ndryshimi rregullativ: nëse kërkohet të aplikohen ndryshime jo-rregullative për të krijuar fleksibilitet shtesë në organizimin e brendshëm të gjykatës.	Të aplikohet një kalendar për rezervimin e resurseve të përkthyesve në një lokacion të gjykatës (bazuar në të dhënat në dispozicion lidhur me pjesëmarrësit e ftuar në seanca) për të shmangur mbivendosjen (dyfishimin) dhe sistemin e zëvendësimit të

				përkohshëm të stafit mbështetës në mënyrë që gjatë çdo vikendi/pushimi të jetë caktuar një zëvendësimit.
	1.5. Numri i vogël i stafit ndihmës për gjyqtarët	Të mos bëhet asgjë: gjyqtarët do të vazhdojnë të merren me detyra jo-gjyqësore dhe të kenë më pak kohë për gjykim	Ndryshimi rregullativ: sigurimi i mandatit në ligjin procedural për këshilltarët ligjorë që të nënshkruajnë urdhrat dhe letrat e pa-apelueshme të gjykatës në mënyrë që të zvogëlohet ngarkesa me punë e gjyqtarëve	Sigurimi i resurseve shtesë për angazhimin (punësimin) e këshilltarëve ligjorë për gjyqtarët në mënyrë që të ketë mesatarisht nga një asistent ligjor që mbështet dy gjyqtarë.
2. Korniza ligjore nuk mbështet procedurën efikase dhe efektive	2.1. Nuk ka mandat dhe obligim gjyqësor për të konstatuar faktet e lëndës; nuk ka mandat për të siguruar ekzekutimin e vendimeve nga organet administrative	Të mos bëhet asgjë: pingpongu me lëndët do të vazhdojë, gjykatat po ashtu do të jenë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve, organet administrative nuk do të mbahen përgjegjëse.	Ndryshimi rregullativ: gjykata do të ketë obligimin të konstatojë faktet e lëndës me vet iniciativën e saj, nëse është e nevojshme bashkë me mandatin për tu shqiptuar gjopa organeve të cilat nuk respektojnë urdhrat e saj (shih 1.2.) ose që nuk i ekzekutojnë vendimet.	Sigurimi i më shumë resurseve në gjyqësor për të mundësuar procedimin më të shpejtë të lëndëve (dhe sa herë që të jetë e nevojshme) edhe ekzekutimin e vendimeve të saj. Kostot do të rriten shumë (për shtetin e po ashtu edhe për individët të cilët duhet të parashtrojnë të njëjtën ankesë disa herë në gjykatë), organet administrative nuk do të mbahen përgjegjëse.
	2.2. Mospërputhjet në mbrojtjen gjyqësore kundër akteve administrative të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK)	Të mos bëhet asgjë: gjyqtarët që merren me lëndët civile do të merren me ankesat kundër AKK-së, ata nuk do të kenë njohuri për ligjin administrativ dhe mund të pësojë cilësia e vendimeve.	Ndryshimi rregullativ: Ndryshimi i Ligjit për Gjykatat në mënyrë që ankesat kundër akteve dhe veprimeve administrative të AKK-së të jenë nën kompetencën e AKK-së.	-
	2.3. Procedura ankimore jo-konsistente dhe joefikase në lëndët e kundërvajtje	Të mos bëhet asgjë: ankesat për vendimet e kundërvajtjes do të vërshojnë DÇA-në dhe DÇA do të jetë në gjendje të anulojë një vendim dhe t'ia	Ndryshimi rregullativ: Ligji për Kundërvajtje duhet të ndryshohet në mënyrë që ankesat kundër vendimeve për kundërvajtje të	Sigurimi i resurseve nga departamentet e përgjithshme të gjykatës themelore (gjyqtarët, etj) për DÇA-në që ajo të merret me numrin në rritje të ankesave kundër

ve	kthej prapa organit administrativ duke zgjatur kështu procedurat.	parashtrihen në të njëjtin departament në gjykatën themelore që merret me lëndët e kundërvajtjes edhe si organ gjyqësor i shkallës së parë.	vendimeve të kundërvajtjes. Kjo do t'i mundësojë gjykatës të merret me numrin në rritje të lëndëve, por nuk do të mbështes specializimin e gjyqtarëve, duke ndikuar kështu në kompetencën e gjyqtarëve. Procedurat e ankesës do të jenë më pak efikase për shkak të mandatit të kufizuar të DÇA-së.
2.4. Gjyqtarët detyrohen të punojnë paralelisht me dy kode të procedurës (LKA dhe LPK)	Të mos bëhet asgjë: gjyqtarët e DÇA-së do të duhet të vazhdojnë të punojnë me 2 kode të procedurës	Ndryshimi rregullativ: krijimi i një ligji gjithëpërfshirës për kontestet administrative i cili rregullon të gjitha fazat e procedurës së gjykatës administrative	-
2.5. Dispozitat e LKA-së nuk mbështesin procedurat efikase	Të mos bëhet asgjë: Afatet për t'iu përgjigjur gjykatës do të mbesin më të gjata për autoritetet publike se sa për pjesëmarrësit në procedurë civile, organet publike vazhdojnë të kenë mundësi ligjore të shmangin dërgimin e dokumenteve, nuk lejohet komunikimi elektronik me publikun.	Ndryshimi rregullativ: shkurtimi i afatit për t'iu përgjigjur gjykatës në 15 ditë (si në LPK), të mos rregullohet mundësia e përpjekjes së dytë për dorëzim [të dokumenteve], dhe krijimi i mundësisë për komunikim elektronik me organet publike (shih po ashtu 1.3.)	-
2.6. Tepër shumë mundësi të obligueshme të apelit/ankesës brenda administratës	Të mos bëhet asgjë: procedura administrative ankimore të gjata, të kushtueshme dhe të cilësisë së dobët.	Ndryshimi rregullativ: të bëhet jo e detyrueshme ankesa administrative (të paktën në këto fusha ku ndikimi i ekzistimit të organeve administrative të apelit si filtra është më i vogli), në mënyrë që ankesat kundër akteve administrative të mund të parashtrihen	Sigurimi i resurseve shtesë për trajnimin e organeve administrative të apelit për të rritur cilësinë dhe efektivitetin e tyre si filtër paragyqësor.

			drejtpërdrejtë në gjykatë ose në mënyrë alternative përmes një organi administrativ të apelit.	
3. Problemet lidhur me qasjen në drejtësi	3.1. Sipas LKA-së të dyja palët bartin shpenzimet e veta pavarësisht se argumenti i kujt triumfon	Të mos bëhet asgjë: qasja në drejtësi do të jetë e kufizuar për shkak të kostos potenciale të lartë të procedurave gjyqësore	Ndryshimi rregullativ: Nëse organi administrativ humbet në një lëndë, atëherë ai duhet t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës palës tjetër (në një masë të arsyeshme të përcaktuar me ligj dhe/ose në praktikën gjyqësore). Nëse pala ankuese humb, atëherë ankuesi mbulon shpenzimet e veta, por jo edhe shpenzimet e organit administrativ, sepse administrata e përfaqëson vetveten.	-
	3.2. Nuk ka mbrojtje gjyqësore kundër veprimeve administrative të paligjshme dhe mosveprimit sipas LKA-së	Të mos bëhet asgjë: do të vazhdohet të mos ketë qasje në drejtësi administrative në rastet e veprimit të paligjshëm dhe mosveprimit (heshtjes administrative)	Ndryshimi rregullativ: Krijimi i mbrojtjes gjyqësore kundër veprimeve të paligjshme dhe mosveprimit të administratës (ngjashëm me ankesën administrative të përcaktuar në LPPA).	-
4. Mosbesimi në gjyqësor	4.1. Mosbesimi në gjyqësor	Të mos bëhet asgjë: besimi do të mbetet ashtu siç është, njerëzit nuk do tu drejtohen gjykatave për mbrojtje kundër administratës, administrata bëhet edhe më pak e përgjegjshme (llogaridhënëse).	Ndryshimi rregullativ: përcaktimi i obligimit të gjykatës që të publikojë në internet të gjitha vendimet përfundimtare në lëndët administrative. Nëse ankuesi kërkon, të dhënat e tij/saj personale (emri, adresa, etj.) mund të hiqen nga versioni i publikuar.	Zbatimi i të gjitha masave të nevojshme jo-rregullative për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të gjykatës (shih 1.3., 1.4., 1.5. dhe 2.6.).

Aneksi 2. Ligjet dhe aktet nënligjore

Për rregullimin e fushës së gjyqësisë administrative, përveç Ligjit për konfliktet administrative, i cili mbulon dhe rregullon drejtëpërdrejt këtë fushë, edhe ligjet tjera në mënyrë të tërthortë ndikojnë në raport me këtë çështje.

Ligjet:

Ligji Nr. 03/L-202 për konfliktet administrative - Me këtë ligj rregullohen kompetenca, përbërja e gjykatës dhe rregullat e procedurës, në bazë të të cilave gjykatat kompetente, vendosin për ligjshmërinë e akteve administrative me të cilat organet kompetente të administratës publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik dhe palëve të tjera, si dhe për ligjshmërinë e veprimeve të organeve administrative. Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera, të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me vendime individuale ose me veprimet e organeve të administratës publike.

Ligji Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative - Ky Ligj ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave. Ky ligj zbatohet në çdo rast kur një organ publik në realizimin e autoritetit publik vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ, lidhjen e një kontratë administrative, ose zbatimin e kompetencave të veta përmes akteve reale, që kanë të bëjnë me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave.

Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës - Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) duke përfshirë procedurat për rekrutim, emërim, riemërim, transferime, disiplinë, vlerësim, ngritje në detyrë dhe trajnim të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë; për menaxhimin dhe administrimin e gjykatave, për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit; dhe themelimin e gjykatave dhe degëve të reja.

Ligji Nr. 03/L-199 për gjykatat (me plotësim/ ndryshimet e tij, Ligji Nr. 04/L-171 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat, Ligji Nr. 05/L-032 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat, Ligji Nr. 04/L-171 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-199 për gjykatat - Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin dhe juridikcionin e gjykatave në Republikën e Kosovës. Me nenin 12, paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 parashihet se departamenti për Çështjet Administrative që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinë, vepron për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore - Me Ligjin për procedurën kontestimore caktohen rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe. Ligji aktual për konfliktet administrative me nenin 63, parashihet zbatimin e këtij ligji në mungesë të dispozitave përkatëse.

Ligji Nr. 05/L-087 për kundërvajtjet - Me këtë ligj rregullohen kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje,

procedura e kundërvajtjes, procedura e veçantë për të mitur dhe procedura e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje. Me nenin 64 të këtij ligji, parashihet se kundër vendimit përfundimtar për kundërvajtje, të cilën e ka nxjerrë organi i kundërvajtjes, mund të paraqitet padia për zhvillimin e kontestit administrativ. Padinë mund ta paraqes personi (fizik ose juridik), ndaj të cilit i është shqiptuar sanksioni, përfaqësuesi i tij ligjor, përkatësisht mbrojtësi, i dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij, si dhe pronari i sendit të konfiskuar/marrë dhe në procedurën e kundërvajtjes.

Ligji Nr. 04/L-193 për avokatinë - Me këtë ligj rregullohen kushtet për ushtrimin e avokatisë, mënyrat dhe format e punës, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e avokatëve dhe praktikantëve, organizimi dhe puna e Odës së Avokatëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Oda), si dhe çështje tjera të rëndësishme për ushtrimin e avokatisë. Me nenin 6 të këtij ligji rregullohet e drejta e ushtrimit të avokatisë, në rastet e refuzimit të kësaj të drejte atëherë kundër vendimit të Komisionit për ankesa mund të inicohet konflikti administrativ. Po ashtu edhe sipas nenit 55 parashihet mundësia e hapjes së konfliktit administrativ për rastet e revokimit të licencës, masave disiplinore, etj.

Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit - ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë - Me këtë ligj themelohet Akademia e Drejtësisë dhe rregullohet statusi, funksionet dhe organet e saj, mënyra dhe kushtet sipas të cilave kryhet trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të Republikës së Kosovës, trajnimi i personelit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe çështje të tjera në pajtim me ligjin.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik - siguron mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do tëzbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet etj. Gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit.

Ligji Nr. 03/L-048 menaxhimin e financave publike - Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë parimet e politikës fiskale dhe kornizën ligjore për përgatitje dhe implementim të Buxhetit të Republikës së Kosovës, që synon të mbajë borxhin në nivele të qëndrueshme me anë të konsistencës ndërmjet bilanceve buxhetore, niveleve të borxhit, dhe rritjes ekonomike afatmesme; dhe t'i akordojë Ministrin autoritetin dhe përgjegjësinë për përgatitje dhe implementim të Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe të amendamenteve të tij, për të shmangur apo kompensuar një deficit të tepruar apo për të rivendosur kufirin e deficitit. Përmes këtij ligji themelohet Avokatura Shtetërore.

Ligji Nr. 04/L-157 për avokaturën shtetërore - Me këtë ligj rregullohet themelimi, organizimi dhe kompetencat e Avokaturës Shtetërore të Republikës së Kosovës, kushtet dhe procedura për emërimin dhe shkarkimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe të avokatëve shtetëror, mjetet për punë, autorizimet e tyre, të drejtat dhe detyrimet, si dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e saj. Avokatura shtetërore përfaqëson, jep këshilla dhe mbron autoritetet publike të Republikës së Kosovës, të përcaktuara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, në procedurën gjyqësore, të arbitrazhit dhe në procedurën administrative në pajtim me ligjin.

Ligji Nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës - Ky ligj rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale. Sipas këtij ligji organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, si dhe përcakton rregullat për menaxhimin dhe organizimin e përgjithshëm të një shërbimi civil të paanshëm politikisht, rregullat për pranimin në të, kushtet e punës, të drejtat dhe detyrimet, sjelljen personale, avancimin në karrierë, si dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civilë. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës. Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave themelohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e kontesteve dhe pranimin e ankesave. Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës.

Ligji Nr. 03/L-051 për aviacionin civil - Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha veprimtaritë në fushën e aviacionit civil të cilat zhvillohen brenda territorit dhe hapësirës ajrore të Kosovës. Neni 98 I këtij ligji parasheh se personi i cili është subjekt i gjobës administrative dhe/ose shfuqizimit ose pezullimit të certifikatës, licencës, ose lejes, në përputhje me nenet 96 ose 97 të këtij ligji, ka të drejtë ta kontestojë këtë shfuqizim ose pezullim në përputhje me ligjin e përgjithshëm të procedurës administrative.

Ligji Nr. 04/L-217 për azil - Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuësve, personave me status refugjati, si dhe personave të cilëve iu është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme. Sipas këtij ligji, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është përgjegjëse për vendosje në shkallën e parë lidhur me kërkesën për azil, ndërsa Komisioni Kombëtar për Refugjatë është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të drejtuara kundër vendimeve të shkallës së parë. Gjykata kompetente në përputhje me Ligjin për Gjykatat, është përgjegjëse për shqyrtimin e vendimeve administrative.

Ligji Nr. 2011/04-L-063 për hekurudhat e Kosovës - Qëllimi i këtij ligji është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit hekurudhor, përmirësimin e sistemit të sigurisë, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese të operatorëve dhe ofrimi i shërbimeve në tregun e sektorit hekurudhor. Ky ligj rregullon: funksionet dhe kompetencat e shtetit dhe të entiteteve hekurudhore që janë të ngarkuar me zhvillimin e sektorit hekurudhor; rrjetin dhe infrastrukturën hekurudhore; operimet dhe shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore; shfrytëzuesit e infrastrukturës hekurudhore; sigurinë e sistemit hekurudhor; kërkesat e sigurisë për sistemin hekurudhor; interoperabilitetn e sistemit hekurudhor në Kosovë; modernizimin dhe ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore; dispozitat mbi shërbimet e transportit hekurudhor dhe shërbimet në interes të publikut të ofruara nga sistemi hekurudhor. Sipas nenit 54, paragrafi 18 parashihet që padia kundër vendimit të Autoritetit rregullativ të hekurudhave të Kosovës referuar në këtë ligj mund të iniciohet, ndërsa procedura administrative duhet të iniciohet në gjykatën kompetente brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Ky ligj përcakton organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës. Këshilli është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili zgjidh ankesat e nëpunësve si dhe siguron respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i zgjidh ankesat e nëpunësve si dhe siguron respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës në organet e

administratës publike në degën e ekzekutivit. Sipas nenit 14 të këtij ligji, parashihet që kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale - Ky Ligj përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe themelon Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale që është përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave. Me nenin 49, parashihet që kundër vendimit përfundimtar të mbikëqyrësit me të cilin konstatohen shkeljet dhe shqiptohen masat e inspektimit, nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente.

Ligji Nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike - Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës. Po ashtu ky ligj themelon Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Kundër vendimeve të Autoritetit mund të inicohet konflikti administrativ.

Ligjin Nr. 03/L-163 për miniera dhe mineraleve - Qëllimi i këtij ligji është promovimi në përputhshmëri me standardet e pranuarra mjedisore, i hulumtimit, nxjerrjes dhe pasurimit të Mineraleve përmes rregullimit dhe mbikëqyrjes së personave të angazhuar në industrinë minerare, lehtësimi dhe mbështetja e një pjesëmarrje dhe konkurrence më të madhe të sektorit privat në industrinë minerare, maksimalizimi i hulumtimit dhe shfrytëzimit të Mineraleve, si dhe rregullimi i mbledhjes, menaxhimit dhe arkivimit të të dhënave gjeo-shkencore për të mirën e Republikës së Kosovës. Po ashtu, ky ligj themelon Komisionin e Pavarur i Minierave dhe Mineraleve. Sipas nenit 61, paragrafi 5, personi i cili ndikohet negativisht nga një vendim i Bordit të KPMM sipas këtij neni, mund ta kundërshtojë vendimin në përputhje me ligjin e Kosovës mbi konfliktin administrativ ose nëse personi në fjalë është Drejtori i KPMM-së Ligjin për Shërbimin Civil. Sipas nenit 60 paragrafi 3, parashihet se Anëtar i përkatës i Bordit mund ta kundërshtojë vendimin e Kuvendit për shkarkim të tij, në përputhje me ligjin e Kosovës për konfliktin administrativ.

Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave - Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e kompetencave të Komisionit të Pavarur të Mediave me qëllim të promovimit të zhvillimit të një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale audiovizuale që u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Po ashtu, ky ligj themelon Komisionin e Pavarur të Mediave. Sipas nenit 44 vendimet e Bordit për Ankesa janë përfundimtare dhe u nënshtrohen vetëm shqyrtimit procedural të Gjykatës Supreme të Kosovës, në pajtim me ligjin në fuqi.

Ligji Nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës - Me këtë ligj themelohet Administrata Pensionale e Kosovës (më tej "Administrata") si njësi administrative në kuadër të MPMS. Sipas këtij Ligji mund të inicohet konflikti administrativ kundër vendimit të me të cilat refuzohet kërkesa për dhënie të licencës për fond pensional. Gjithashtu kundër vendimeve për lidhet me kursimet pensionale të Bordit Drejtues të fondit si shkallë e dytë mund të inicohet konflikti administrativ.

Ligji Nr.03/L-200 për greva - Ky ligj ka për qëllim garantimin e lirive dhe të drejtave, lidhur me organizimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarve në Kosovë në grevë sipas standardeve ndërkombëtare. Me këtë ligj rregullohen dhe përcaktohen të drejtat e të punësuarve në grevë,

kushtet dhe mënyra e organizimit të grevës, si dhe të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve dhe punëdhënësve gjatë mbajtjes së grevës. Me nenin 19 parashihet se kur greva shoqërohet me veprime të paligjshme, palët i drejtohen gjykatës kompetente, e cila e përcakton përgjegjësitë e palëve, i cakton veprimet që ato duhet t'i kryejnë, e cakton dëmin e shkaktuar dhe detyrimet e palës për zhdëmtimin e atij dëmi. Në rast kontesti lidhur me ligjshmërinë e grevës, palët mund t'i drejtohen Gjykatës Kompetente.

Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit - Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave si dhe caktimi i mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit. Banesat me qira nga programet e veçanta të banimit administrohen nga Organi Kompetent Komunal. Kundër vendimit të Organit kompetent komunal që mbulon fushën e banimit, pala e pa kënaqur mund të parashtojë ankesë me shkrim – Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila duhet ta shqyrtojë ankesën dhe ta njoftojë me shkrim parashtruesin e ankesës për vendimin e marrë, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë, pas pranimit të ankesës. Pala e pakënaqur me vendimin e Ministrisë, ka të drejtë padie për inicimin e konfliktit administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.

Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar - rregullon dhe përcakton të drejtat, kushtet, mënyrat e aftësim, riaftësim profesional dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara, për integrimin e tyre në tregun e hapur të punës sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në legjislacionin e aplikueshëm.

Ligji Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër - i cili rregullon të drejtat dhe përfitimet si dhe përcakton kriteret për kategorizimin e personave të verbërve. Me këtë ligj personat e verbër mbrohen nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes talljes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Ligji Nr. 03/L-022 për Përkrahjen Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme - rregullon të drejtën për përkrahje materiale familjeve të cilët ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme dhe mënyrën e realizimit të kësaj përkrahje materiale. Sipas nenit 23 të këtij Ligji, Vendimi i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale i shkallës së dytë lidhur me ankesat kundër vendimeve të Qendrës për Punë Sociale është akt përfundimtar në procedurë administrative, andaj pala e pakënaqur me vendimin e shkallës së dytë të MPMS-së ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kompetente.

Ligji Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror - Qëllimi i këtij ligji është themelimi i Agjencisë për Shërbimin e Navigacionit Ajror – ASHNA për të siguruar infrastrukturën dhe shërbimet e navigimit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Me nenin 12 rregullohen kontestet administrative. Ky nen parasheh që përveç nëse kontesti ka të bëjë me një shkelje të dyshuar të Ligjit të Prokurimit Publik, çdo person i cili ka një interes të veçantë dhe është i/e dëmtuar nga ndonjë veprim procedural, përmbajtësor, lëshim të Drejtorit ose të personelit ASHNA-s dhe i cili beson se një veprim ose lëshim i tillë është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose me legjislacionin në fuqi mund ta kontestojë veprimin ose lëshimin e tillë në përputhje me Ligjin e Përgjithshëm të Procedurës Administrative.

Ligji Nr. 04/L-011 për organizimin sindikal në Kosovë - Ky ligj ka për qëllim të rregullojë dhe të përcaktojë të drejtat dhe liritë e të punësuarëve për themelimin dhe organizimin e lirë dhe vullnetar në organizata sindikale në sektorin publik dhe privat, me qëllim të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave ekonomike, sociale dhe profesionale të punëtorëve nga puna dhe marrëdhënia e punës. Sipas këtij ligji, kundër vendimit të MPMS-së, pala e pakënaqur, në afat

prej tridhjetë (30) ditësh, mund të ushtrojë padi për fillimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente, nga dita e pranimit të vendimit.

Ligji Nr. 04/L -261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Me këtë ligj përcaktohen të drejtat në beneficione për Veteranët e UÇK-së dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave, siç është përcaktuar në nenin 12 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre. Kundër Vendimit të Komisionit sipas kërkesave të palëve në bazë të këtij ligji, pala e pakënaqur ka të drejtë që të iniciojë procedurën në Gjykatën kompetente.

Ligji Nr. 04/L-219 për të huajt - Ky ligj rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Kundër vendimeve të Komisionit të Ankesave sipas kërkesave të këtij Ligji, mund të iniciohet konflikti administrativ.

Ligji Nr.04/L-013 për Kadastër - Ky ligj rregullon kadastrin e palujtshmërive, matjet shtetërore dhe kadastrale, punët gjeodezike dhe kadastrale si dhe përfitimin, regjistrimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e të dhënave kadastrale. Po ashtu, ky ligj themelon Agjencionin Kadastral të Kosovës. Me nenin 28 të këtij ligji, është paraparë mundësia e inicimit të konfliktit administrativ kundër vendimeve të Agjencionit Kadastral të Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë - Ky ligj përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, certifikimin e aktiviteteve të operatorëve të transmetimit në sektorin e energjisë procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji. Po ashtu, ky ligj themelon Zyrën së Rregullatorit për Energji. Sipas nenit 26, paragrafi 3 Aktet e lëshuara nga Rregullatori në bazë të paragrafit 1. të këtij neni, u nënshtrohen procedurave të shqyrtimit administrativ brenda Zyrës së Rregullatorit për Energji. Pas shqyrtimit në fjalë aktet e tilla nuk mund të rishikohen apo kontestohen nga asnjë institucion publik, përveç shqyrtimit gjyqësor në gjykatën kompetente të Kosovës, sipas Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjithashtu me nenin 49 parashihet se Palët e pakënaqura me Vendimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji në lidhje me tarifat e rregulluara dhe metodologjinë e tarifave mund të iniciojnë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të Vendimit.

Ligji Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit - Me këtë ligj harmonizohen zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian. Po ashtu, ky ligj themelon Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Me nenin 87 të këtij ligji, është paraparë mundësia e inicimit të konfliktit administrativ kundër vendimeve finale të Agjencionit.

Ligji Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës - Qëllimi i Ligjit të arsimit të lartë është krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në përputhje me standardet evropiane si dhe rolin e shtetit dhe shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Po ashtu, ky ligj themelon Agjencionin për Akreditim. Sipas këtij ligji, kundër vendimit për mosdhënie apo revokim të licencës, vendimet lidhur me gradat dhe vendimet tjera të Ministrisë së Arsimit si dhe kundër vendimit për mosakreditim nga Agjencia për Akreditim, mund të inicohet konflikti administrativ.

Ligji Nr. 03/L-069 për Akreditim dhe Ligji Nr. 04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-069 për akreditim - Me këtë ligj themelohet Drejtoria e Akreditimit, si dhe përcaktohen rregullat e funksionimit të sistemit të akreditimit të organit kompetent për vlerësim të konformitetit. Kundër vendimeve të Drejtorisë pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, të cilat shqyrtohen nga Komisioni i shqyrtimit të ankesave. Nëse komisioni nuk përgjigjet në afatin e caktuar ose kthen përgjigje me të cilën pala është e pakënaqur, pala mund të ngrejë kontest administrativ brenda tridhjetë (30) ditësh.

Kodi Nr.03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë - Me këtë Kod themelohet Dogana e Kosovës. Me nenin 291 parashihet inicimi i konfliktit administrativ nga pala e pakënaqur kundër vendimeve të Bordit të Pavarur për ankesa (i cili është shkallë e dytë kundër vendimeve të Doganës së Kosovës).

Ligji Nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizimit - Ky ligj përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit. Po ashtu, ky ligj themelon Njësinë për Inteligjencë Financiare. Neni 52, paragrafi 1 parashihet inicimi i konfliktit administrativ kundër vendimeve me të cilat shqiptohen ndëshkimet administrative nga Njësia për Inteligjencë Financiare e Republikës së Kosovës, Banka Qëndrore e Kosovës dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial.

Ligji Nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës - Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social - ekonomik të Republikës së Kosovës, të themelojë procedura dhe parime udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore, mbështetur në shfrytëzimin dhe qëllimin, të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi si dhe të përcaktojë strukturat institucionale për administrimin e resurseve ujore. Sipas nenit 100, kundër vendimit të Komisionit të pavarur për ankesa si shkallës së dytë lidhur me vendimet e inspektorit të ujrave, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrijë padi për konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit.

Ligji Nr.03/L-231 për Inspektoriatin Policor të Kosovës - Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Policor të Kosovës. Po ashtu, ky ligj themelon Inspektoratin Policor të Kosovës. Sipas nenit 22 të këtij ligji, parashihet inicimi i konfliktit administrativ nga punonjësi i policisë kundër vendimit të Ministrit të lidhur me ankesën kundër vendimit për masën disiplinore të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

Ligji Nr.02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor - Me këtë ligj themelohet Inspektorati Shëndetësor. Me nenin 11 të këtij ligji është paraparë se kundër vendimit përfundimtar të Inspektoratit shëndetësor mund të ngritët kontest administrative në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh.

Ligji Nr.04/L-029 për Patenta dhe Ligji Nr. 05/L - 039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-029 për patenta - Me këtë ligj përcaktohen kushtet dhe procedurat për regjistrimin e patentës, të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave. Po ashtu, ky ligj themelon Agjencionin për Pronësi Industrial. Me nenin 6 të këtij ligji parashihet se kundër vendimit të Agjencionit mund të parashtrijë ankese, për të cilën vendos Komisioni për ankesa të themeluar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Kundër vendimit të Komisionit mund të ushtrohet padi për inicim të konfliktit administrativ në afat prej 30 ditësh.

Ligji Nr.2004 / 5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, Ligji Nr. 02/L-089 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, Ligji Nr. 03/L-138 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë - Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i sektorit të naftës dhe derivateve të naftës që ka të bëjë me tregtimin, licencimin dhe monitorimin e rregullt të tregut me naftë dhe derivate të naftës, përmes nxitjes së konkurrencës dhe eliminimit të praktikave të pa lejuara tregtare. Përmes këtij ligji themelohet Zyrja e Licencimit, kundër vendimeve të së cilës palët mund të parashtrorjnë ankesë në Komisionin e emëruar nga Ministri i Tregtisë. Kundër vendimit të Komisionit, pala e pakënaqur mund të iniciojë kontest administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurën administrative.

Ligji Nr.03/L-203 për Metrologjisë dhe Ligji Nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për metrologji - Ky ligj rregullon sistemin e njësive matëse, etalonët shtetërorë, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e para-paketuara, autorizimet në fushën e metrologjisë, mbikëqyrjen metrologjike si dhe përgjegjësitë e Drejtoratit të Metrologjisë të Kosovës. Sipas neni 44 të këtij ligji, kundër vendimit të inspektorit të metrologjisë pala mund të parashtrorjë ankesë në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Ndërsa kundër vendimit të Drejtorit pala në afat prej dhjetë (30) ditësh mund të shtroj ankesë të shkallës së dytë pran Komisionit profesional për ankesa, që formohet me vendim të Sekretarit të MTI-së, i cili është vendim i plotfuqishëm. Kundër vendimit të Komisionit profesional për ankesa mund të parashtrorhet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Ligji Nr.03/L-181 për Inspektoratin e Tregut dhe Ligji Nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut - Me këtë ligj përcaktohen parimet, organizimi, kompetencat dhe procedurat e mbikëqyrjes inspektuese të tregut në territorin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, ky ligj themelon Inspektoratin e Tregut. Me nenin 27 të këtij ligji parashihet se kundër aktvendimit të inspektoratit lejohet ankesë brenda afatit prej tetë (8) ditëve kalendrike nga dita e dorëzimit të aktvendimit për të cilën vendos Kryeinspektori. Kundër aktvendimit të Kryeinspektorit mund të parashtrorhet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Ligji Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe Ligji Nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare - parashihet që pala e pa kënaqur me vendimin e Kryeshefit të ARBK-së në afatin prej tetë (8) ditësh ushtron ankesë në Komisionin për parashtrësia dhe ankesa. Kundër vendimit të Komisionit për Parashtrësia dhe Ankesa pala e pa kënaqur në afatin prej tridhjetë (30) ditësh mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës - Me këtë ligj përcaktohen rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kompetencat, organizimi i Autoritetit për mbrojtjen e konkurrencës si dhe procedurat në zbatim të këtij ligji. Me nenin 62 të këtij ligji parashihet që kundër vendimit të Autoritetit, me të cilin konstatohet shkelja e këtij ligji dhe shqiptohet masa ndëshkuese si dhe vendimit me të cilin ndërpritet procedura për shkak të çështjeve paraprake, nuk është e lejuar ankesa, mirëpo pala në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, me padi mund të iniciojë konfliktin administrativ në Gjykatën kompetente të Kosovës. Gjithashtu me nenin 33 paragrafi 5, nenin 35 paragrafi 6, neni 38 paragrafi 3, neni 48 paragrafi 5 parashihet iniciimi i kontestit administrativ kundër vendimeve të Autoritetit për mbrojtjen e konkurrencës.

Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat - Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për administrimin e tatimeve dhe kontributeve, si dhe Ligji Nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Administratën Tatimore dhe

procedurat Nr. 03/L-222 ka për qëllim krijimin e procedurave të reja ankimore kundër vendimeve të organeve tatimore.

Aktet nënligjore

Ligji aktual për konfliktet administrative nuk ka paraparë nxjerrjen e akteve nënligjore.